

Udhëzuesi Y+



Udhëzues i punës me të rinjtë e rrezikuar



Udhëzuesi Y+

**Udhëzues i punës me
të rinjtë e rrezikuar**



Impressum

Autorë:

Martina Horvat
Gabrijela Ratkajec Gašević
Elizabeta Matković

Publikuar:

Zyra qendrore e CARE Gjermani në BeH (CARE në
Bosnje dhe Hercegovinë)
Rr. "Hasana Kaimije" nr. 11
71 000 Sarajevë
Bosnje dhe Hercegovinë
www.care-balkan.org
www.youngmeninitiative.net
care@care.ba

Për publikuesin:

Sumka Bučan, Drejtore Rajonale

Dizajni:

SMART Kolektiv



E drejta e autorit © 2022 CARE International në Bosnjë dhe Hercegovinë. Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të kopjohet ose dhurohet në asnjë formë e në asnjë mënyrë, qoftë ajo mënyrë elektronike, mekanike apo tjetër, përfshirë (por jo edhe kufizuar në) fotokopjimin, regjistrimin ose përdorimin e informacionit kërkimor, pa pëlqimin me shkrim të autorit ose pronarit të së drejtës së autorit. Marrëdhënia ndërmjet botuesit dhe autorëve është e rregulluar me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Lidhura të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Botimi i këtij publikimi u mbështet nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Përmbajtja dhe përfundimet e këtij publikimi nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e qeverisë austriake.

CARE International



Në rajonin e Ballkanit, CARE International ka mbi 25 vjet përvojë në zbatimin e programeve. Gjatë luftërave dhe konflikteve të viteve 1990, CARE ka ndërhyrë pas shkatërrimit, traumatizimit, zhvendosjes dhe urrejtjes ndëretnike, përmes punës së tyre të madhe humanitare dhe shpëtimtare në të gjithë Ballkanin. Që nga viti 2000, orientimi i CARE është zhvendosur në punë zhvillimore dhe qëllimi i tyre sot në Ballkan është të sigurojë njohjen dhe përmbushjen e të drejtave sociale, ekonomike dhe politike të grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara, duke kontribuar kështu në paqen e qëndrueshme në rajon.

Strategjia e programeve të CARE bazohet në dy shtylla: a) Përfshirja socio-ekonomike e pakicave të cënueshme dhe grupeve të tjera të marginalizuara përmes kontributit në ndërtimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e mundësive për ta, t'u mundësojë atyre të integrohen në shoqëri si dhe të kenë qasje në të drejtat e tyre, b) Barazia gjinore e grupeve të cënueshme dhe të marginalizuara përmes promovimit të vlerave dhe praktikave të barazisë gjinore, diversitetit dhe jo dhunës, fuqizimit të kapaciteteve të aktorëve lokalë, kombëtarë dhe rajonalë për të drejtat e njeriut, drejtësinë sociale dhe krijimit të mundësive për inovacion, pjesëmarrje, të mësuar, bashkëpunim dhe avokim. CARE promovon partneritetet me sektorin lokal të shoqërisë civile dhe qeveritë e zotuar për të kontribuar në ndryshime pozitive në shoqëri.

YMI - Young Men Initiative



Projekti Young Men Initiative (YMI) filloi në vitin 2006 dhe po zbatohet nga CARE International Ballkan dhe organizatat partnere lokale në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kroaci, Kosovë dhe Serbi. Projekti është një vazhdimësi e përpjekjeve gjithëpërfshirëse dhe programatike të CARE për të parandaluar dhunën ndërpersonale dhe mbi bazë gjinore (DhBGj), si dhe për të promovuar barazinë gjinore në rajon. YMI mëton të rinjtë të ndërtojnë njohuritë dhe qëndrimet e tyre për barazi gjinore dhe stile të jetesës së shëndetshme dhe të reduktojnë të gjitha format e dhunës. YMI filloi me kërkime cilësore në shkallë të vogël, duke eksploruar qëndrimet dhe sjelljet e të rinjve dhe më pas, me kalimin e viteve, u zhvillua në një program gjithëpërfshirës me komponentë të ndryshëm që kanë prekur të rinjtë, prindërit, profesorët, edukatorët, studentët, gazetarët dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm.

Gjatë viteve të fundit, aktivitetet e YMI janë rritur ndjeshëm, duke arritur në më shumë se 140 qytete/komuna të ndryshme dhe mbi 720,000 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, përmes mijëra aktiviteteve edukative, avokuese dhe/ose fushatave. Shtrirja e përgjithshme indirekte dhe mediatike matet ndoshta në miliona njerëz.

Programet arsimore kanë qenë gjithmonë baza e përpjekjeve të YMI-së. Gjithçka filloi me Programin M (udhëzues për punën veçanërisht me djem të rinj) i bazuar në Programin H të Promundo-s dhe përshtatur me kontekstin ballkanik, duke u mbështetur në rezultatet e kërkimit cilësor dhe sasior në vendet pjesëmarrëse. Programi Y ishte hapi i radhës, evoluimi i mëtejshëm i Programit M, që synonte grupet gjinore të përziera, duke u shtrirë kështu tek më shumë nxënës. Një nga qasjet dhe idetë e reja në zhvillimin e programeve të të rinjve ishte krijimi i Programit Y+, i përshtatur veçanërisht për të rinjtë e rrezikuar në Ballkan.

Përveç punës së vazhdueshme me të rinjtë, janë aftësuar, akredituar dhe përgatitur stafi i shkollës (d.m.th. profesorë, pedagogë, psikologë) në të gjithë Ballkanin, duke i mundësuar atyre që të realizojnë vetë punëtoritë dhe të mbështesin nxënësit dhe edukatorët e tyre bashkëmohatarë. Klubet "Bëhu burrë" (BMC) janë një tjetër përparësi e vëçantë e programit, sepse ato janë klube të aktivistëve të rinj me anëtarë nxënës dhe edukatorë bashkëmohatarë të përfshirë në program. BMC-të bazohen në pjesëmarrjen dhe angazhimin e të rinjve dhe janë të fokusuar në hartimin, organizimin dhe zbatimin e veprimeve të ndryshme publike në shkolla dhe komunitete, të cilat përhapin më tej mesazhet dhe vlerat e programit. Proçesi pjesëmarrës ka qenë gjithmonë një prej veçorive kryesore të YMI-së dhe të rinjtë kanë qenë gjithmonë të angazhuar në zhvillimin e programeve dhe fushatave të reja.

Përmbajtja

5	Hyrje
6	Fjalorthi i YMI
8	<u>1. Puna me të rinj që përfshin të rinjtë e rrezikuar</u>
10	<u>2. Rëndësia e një qasjeje kritike ndaj normave dhe stereotipeve gjinore gjatë punës me të rinjtë e rrezikuar</u>
13	<u>3. Roli i arsimit joformal në punën me të rinjtë e rrezikuar</u>
15	3.1. Qasjet që fuqizojnë dhe motivojnë pjesëmarrjen dhe ndryshimin
17	3.2. Puna në grup duke përfshirë anëtarët që ndihen nën presion për të marrë pjesë në punën në grup
20	3.3. Filloni të punoni me një grup ku ka rezistencë ose disa anëtarë besojnë se janë të detyruar për të marrë pjesë në një program grupi
21	3.4. Monitorimi dhe vlerësimi i Programit
23	<u>4. Rishikimi i punëtorive</u>
24	Punëtorja nr. 1 – Le t'i vendosim rregullat tona
27	Punëtorja nr. 2 – Kutitë gjinore
30	Punëtorja nr. 3 – Kujdesi për veten
34	Punëtorja nr. 4 – Si i shpreh ndjenjat e mia?
37	Punëtorja nr. 5 – Jam i zemëruar dhe çfarë të bëj?
39	Punëtorja nr. 6 – Nderi pa dhunë
42	Punëtorja nr. 7 – Raportet romantike në mes të të rinjve
45	Punëtorja nr. 8 – Shtrirja e dhunës
47	Punëtorja nr. 9 – Lufta kundër dhunës seksuale
50	Punëtorja nr. 10 – Të kuptuarit e homoseksualitetit
53	Punëtorja nr. 11 – Le të nisim në mënyrë mbrojtëse, jo agresive
56	Punëtorja nr. 12 – Ne ndërtojmë marrëdhënie më të mirë ndërpersonale
59	<u>5. 5. Materialet për vlerësimin e programit</u>
59	5.1 Pyetësori për vlerësimin e procesit në fund të çdo takimi
60	5.2 Pyetësori i kohezionit në grup
61	5.3 Shkalla GEM
65	5.4 Ilustrimet
67	<u>6. Literatura</u>

Hyrje

Udhëzuesi Y+ (që këtej e tutje Udhëzuesi) është zhvilluar për profesionistët dhe punëtorët e të rinjve, të cilët punojnë me të rinjtë në rrezik në organizatat apo institucionet e shoqërisë civile. Të rinjtë në rrezik është një term i përgjithshëm për një numër rrethanash që i vendosin të rinjtë në një pozitë më të cënueshme për shkak të sjelljeve problematike, si abuzimi me substancat narkotike, dështimi në shkollë dhe kriminaliteti tek të miturit, si dhe çrregullimet e shëndetit mendor, si depresioni dhe ankthi (LeCroy & Anthony, 2009). Më konkretisht në kontekstin e këtij Udhëzuesi, rreziqet lidhen me problemet e sjelljes dhe rreziqet në mjedis, të cilat nxisin radikalizimin dhe diskriminimin gjinor.

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është të fuqizojë stafin ose njerëzit që punojnë me të rinjtë, përfshirë ekspertët, për të zbatuar programe në punën e drejtpërdrejtë me të rinjtë e rrezikuar, me qëllim të parandalimit të dhunës, përmirësimit të rregullimit emocional dhe zhvillimit të të menduarit kritik, përmes përqendrimit në drejtësinë gjinore dhe pranimin e diversitetit.

Programi edukativ Y+ rrjedh prej programit “Iniciativa e burrave të rinj” në kuadër të projektit “Future for You(th)”: Të rinjtë si udhëheqës të shkathtësive të jetës në Ballkan, në bashkëpunim me CARE International Ballkan dhe Status M me partnerë nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia.

Qëllimi i Programit Y+ të arsimit joformal, i paraqitur në këtë Udhëzues është të kontribuojë në deradikalizimin dhe risocializimin e të rinjve duke krijuar një mjedis që promovon drejtësinë gjinore dhe lufton dhunën mbi bazë gjinore si dhe të përfaqësojë një përmirësim të programeve ekzistuese të punës për të rinjtë (Programi M dhe Programi Y), vetëm duke u përqendruar dhe duke i'u përshtatur nevojave të të rinjve të rrezikuar. Programi Y+ përfshin të rinj që përballen me rreziqe që lidhen me mjedisin familjar ose probleme të sjelljes dhe konflikte me ligjin, si dhe ata që janë të përfshirë në trajtimin e mirëqenies sociale ose institucionet e drejtësisë.

Pritjet e imponuara në lidhje me normat e ngurta gjinore, sipas statistikave ekzistuese për autorët e veprave penale, mund të çojnë në një prani më të madhe të sjelljeve të dhunshme, problemeve të sjelljes dhe sjelljeve të rrezikshme, madje edhe në kryerjen e veprave penale nga burrat dhe djemtë e rinj. Prandaj, ky program synon të njohë efektet e dëmshme të stereotipeve në sjelljet e dhunshme, të rrezikshme dhe të dënueshme, dhe inkurajon modelet e sjelljes jo të dhunshme, menaxhimin e emocioneve, mbështetjen e diversitetit dhe të menduarit kritik për zgjedhjen e duhur.

Objektivat e Programit Y+ janë:

- › të ndërjegjësohen dhe të analizojnë në mënyrë kritike stereotipet dhe paragjykimet gjinore dhe ndikimin e tyre në sjelljen e pabarabartë dhe kërcënuese (diskriminuese) ndaj njerëzve në lidhje me gjininë,
- › të rritet ndërjegjësimi për pasojat e të gjitha formave të dhunës, veçanërisht dhunës me bazë gjinore, dhe të përmirësohen shkathtësitë e veprimtarojve jo të dhunshëm,
- › të inkurajohet zgjedhja e sjelljes jo të dhunshme,
- › të inkurajohet deradikalizimi dhe zhvillimi i qëndrimeve ndaj drejtësisë gjinore.

Fjalorthi i YMI

AD/HD përfaqëson çrregullimin e mungesës së vëmendjes/hiperaktivitetit.

KËMBËNGULJA në komunikim është prirje që një person të shpreh mendimet dhe ndjenjat e tij guximshëm ose me shumë vetëbesim, me respekt të plotë për bashkëbiseduesin.

DISKRIMINIMI përfaqëson një privilegj, përjashtim ose kufizim mbi bazë gjinore që e vështirëson ose e bën të pamundur që individët të pranojnë, të kenë ose të zbatojnë të drejtat dhe liritë e njeriut.

SUBSTANCAT PSIKOAKTIVE ILEGALE (DROGAT) mund të përkufizohen si çdo substancë që mund të prodhojë ndryshime në funksionimin e organizmave të gjallë, qofshin ato ndryshime fiziologjike apo ndryshime në sjellje.

DHUNA PSIKOLOGJIKE zakonisht paraqet formën më të vështirë për t'a dalluar të dhunës. Mund të përfshijë poshtërimin, kërcënimin, fyerjen, presionin, shprehjen e xhelozisë ose posesivitetin, si kontrollimin e vendimeve dhe aktiviteteve.

DHUNA FIZIKE përfshin përdorimin e forcës fizike, si goditja, shtrëngimi, shuplaka ose shtyrja.

IZOLIMI paraqet një formë dhune në të cilën një burrë e izolon një grua nga familja, miqtë, bota e jashtme me metoda të ndryshme. Izolimi ka shumë forma: fikja e telefonit, mbyllja e një gruaje, ofendimi i miqve të saj, konfiskimi i dokumenteve.

DHUNA është përdorimi i qëllimshëm i forcës fizike ose pushtetit, kërcënimin ose veprimin kundër vetes, një personi tjetër ose një grupi personash apo gjithë komunitetit, e cila mund të ketë pasoja, si lëndim, vdekje, pasoja psikologjike, moszhvillim ose privim.

SEKSI i referohet attributeve dhe karakteristikave biologjike që e identifikojnë një person të caktuar si mashkull apo femër.

KONTROLLI I PLOTË është një formë e dhunës në të cilën dhunuesi kërkon të kontrollojë një vajzë ose një grua. Ngacmuesi është zakonisht kontrolluesi suprem i cili vendos në të gjitha situatat kur bëhet fjalë për jetën e një gruaje. Ai vendos se çfarë duhet të bëjë ajo, kur dhe çfarë duhet të thotë, çfarë të mendojë, kur të bëjë një telefonatë, sa para i nevojiten. Ky kontroll është ai që paraqet si dashuri dhe kujdes ndaj saj.

DHUNA PSIKOLOGJIKE është përdorimi i forcës psikike me qëllim të shkaktimit të dhimbjes mendore, shkaktimit të frikës, cenimit të dinjitetit, rritjes së ndjenjave. Dhuna psikologjike nuk ka pasoja fizike dhe kështu bëhet më e vështirë për t'u njohur, por lë pasoja afatgjata tek viktima.

BARAZIA GJINORE nënkupton dukshmërinë, trajnimin dhe pjesëmarrjen e barabartë gjinore në të gjitha aspektet e jetës publike dhe private. Barazia gjinore është në kundërshtim me pabarazinë gjinore, jo me diversitetin gjinor.

SHËNDETI RIPRODHUES bashkon proceset riprodhuese, funksionet dhe sistemin e organeve në të gjitha fazat e jetës. Prandaj, shëndeti riprodhues nënkupton që njerëzit janë në gjendje të kenë një jetë seksuale të përgjegjshme, të kënaqshme dhe të sigurt dhe aftësinë për të pasur pasardhës, si dhe lirinë për të vendosur nëse do të kenë të tillë, dhe kur e sa shpesh. Prandaj e drejta e burrave dhe grave për t'u informuar dhe për të pasur qasje në metoda të sigurt, efektive, të përballeshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar, që ata zgjedhin, dhe e drejta për të pasur qasje në shërbime të duhura shëndetësore që do t'u mundësojnë grave shtatzëni dhe lindje të sigurt dhe do t'u japin çifteve mundësi më të mirë për të pasur fëmijë të shëndetshëm.

GJINIA i referohet dallimeve dhe pabarazive të ndërtuara nga shoqëria ndërmjet burrave dhe grave (për shembull, se si ata duhet të vishen dhe të sillen). Këto ide dhe pritshmëri mësohen në familje, nga miqtë, institucionet fetare dhe kulturore, shkollat, vendi i punës dhe nëpërmjet mediave.

PABARAZIA GJINORE është një situatë ligjore, sociale dhe kulturore në të cilën seksi ose gjinia përcakton të drejtat e ndryshme dhe dinjitetin e një personi, të cilat reflektohen në qasjen e tyre të pabarabartë ose gëzimin e pabarabartë të këtyre të drejtave, si dhe marrjen e roleve stereotipike në një shoqëri ose kulturë të caktuar.

IDENTITETI GJINOR është ndjenja e brendshme e një personi për gjininë e tij. Prej identiteteve gjinore, më së shpeshti përmenden "mashkulli" dhe "femra", sepse këto identitete janë në përputhje me normat sociale.

STEREOTIPET GJINORE lindin prej supozimeve (shpesh të vjetruara) për rolet, aftësitë dhe karakteristikat e grave dhe burrave. Ato mund të shkaktojnë barriera materiale ose psikologjike që do t'ua bëjnë grave ose burrave të pamundur që të bëjnë zgjedhje ose të gëzojnë të drejtat e tyre të plota.

SHPREHJA GJINORE përfshin personalitetin, pamjen dhe karakteristikat e sjelljes që përkufizohen si mashkullore ose femërore në një kulturë dhe periudhë të caktuar historike.

DhBGj (Dhuna mbi bazë gjinore) është dhunë që bazohet në pritjet gjinore dhe/ose gjininë ose identitetin gjinor të një personi tjetër. Megjithatë DhBGj mund të aplikohet te gratë dhe burrat, vajzat dhe djemtë, theksi i përpjekjeve nga fusha e DhBGj-së është në dhënien fund të dhunës ndaj grave dhe vajzave, meqë ato janë më të prekura nga kjo lloj dhunë.

SEKSUALITETI i referohet shprehjes së ndjenjave, mendimeve dhe sjelljeve tona si burra apo gra. Kjo përfshin ndjenjat tona të tërheqjes, pasionit dhe sjelljes në marrëdhënie intime. Seksualiteti është një shprehje se kush jemi ne si qenie njerëzore – ai përfshin të gjitha ndjenjat, mendimet dhe sjelljet që i kemi si burra ose gra, ndjenjën se jemi tërheqës, se jemi të dashuruar dhe se jemi në një marrëdhënie që përfshin intimitetin dhe aktivitetin fizik seksual.

DHUNA SEKSUALE është çdo akt seksual i padëshiruar ose përpjekje për t'u përfshirë në një akt seksual nëpërmjet frikës fizike, psikologjike ose emocionale, për shembull duke thënë "po të më doje, do të kishe marrëdhënie seksuale me mua". Ashtu si edhe format e tjera të dhunës ndaj grave, faktori bazë i dhunës seksuale shpesh është shprehja e pushtetit mashkullor dhe dominimi mbi gratë.

IDENTITETI SEKSUAL është mënyra se si një person e percepton veten në aspektin e tërheqjes ndaj anëtarëve të gjinisë së tij/saj ose seksit të kundërt bazuar në përvojën, mendimet dhe reagimet e tij/saj, dhe jo në bazë të përcaktimit të tij/saj sipas gjinisë. ose seksit të partnerëve të tij/saj seksual.

PERSON TRANSGJINOR është një person identiteti gjinor i të cilit ndryshon nga ai që i atribuohet në lindje, i cili dëshiron të paraqesë identitetin e tij/saj gjinor në një mënyrë të ndryshme prej tij që i atribuohet në lindje.

KËRCËNIMI është një nga teknikat më të suksesshme të kontrollit. Abuzuesi ushtron kontroll përmes kërcënimit të vazhdueshëm: "Do të t'i djeg flokët, do të hedh nga çatia, do të të bëj copa, do të të gjej kudo që je..." Shpesh këto kërcënime u bëhen fëmijëve ose dikujt që është i afërt me viktimën, si prindërit, motrat dhe vëllezërit.

1. Puna me të rinj që përfshin të rinjtë e rrezikuar

Mosha e të rinjve ndryshon në politikat publike të vendeve të ndryshme evropiane. Në vendet e Ballkanit dhe të BE-së ekziston një përkufizim i ngjashëm për moshën, me disa diskutime për kufirin e sipërm të të rinjve, që zakonisht është midis moshës 24 dhe 35 vjeç, dhe për disa politika ekonomike deri në moshën 40 vjeç.

Një shtrirje kaq e gjerë vitesh tregon se të rinjtë janë grup shumë heterogjen, por në pozicionin e tyre ligjor dallimi kryesor është midis periudhës së adoleshencës (15-18 vjeç) dhe moshës madhore, me theks të veçantë në moshën e hershme madhore (18-21 vjeç).

Sisteme të ndryshme punojnë me të rinjtë, duke pasur objektiva, forma të përfshirjes dhe aktivitete të ndryshme për ta. Ndër to, sistemet më të spikatura janë ato të arsimit formal, të mirëqenies sociale në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të miturve dhe të policisë në kuadër të përgjegjësisë penale dhe mbrojtjes së të miturve dhe të rinjve.

Krahas këtyre formave të punës profesionale formale të institucioneve me të rinjtë, një segment i rëndësishëm i punës zhvillohet brenda organizatave të shoqërisë civile, por edhe brenda organizatave sportive, kulturore, artistike dhe fetare.

Megjithatë, ka disa dallime ndërmjet punës me të rinjtë brenda institucioneve dhe sistemit të arsimit formal dhe punës me të rinjtë brenda sistemit të arsimit joformal dhe organizatave të shoqërisë civile. Në politikat e të rinjve, këto dallime teorikisht përshkruhen më mirë me anë të dy fraza të ndryshme, respektivisht puna me të rinjtë që i përket punës profesionale formale dhe institucionale dhe puna për të rinjtë (Kovačić dhe Čulum, 2015: 25-26). Në kontekstin ballkanik, nuk kemi terme të veçanta, prandaj disa studiues (Kovačić dhe Čulum, 2015: 25-26) për punën e të rinjve përdorin shprehjen përshkruese "punë me të rinjtë në kuptimin e ngushtë", ndërsa në gjuhën serbe, boshnjake dhe malazeze përdoret termi "omladinski rad", në gjuhën sllovene "mladinski rad" dhe në gjuhën shqipe "punëtor rinor".

Puna për të rinjtë përcaktohet gjithashtu ndryshe në vende të ndryshme dhe varet në masë të madhe nga tradita e secilit vend. Mirëpo në nivel të BE-së ajo ka disa karakteristika të përbashkëta si: theksimi i pjesëmarrjes dhe marrëdhënieve vullnetare dhe kujdesi për mirëqenien e të rinjve, si dhe fokusimi tek të rinjtë dhe fuqizimi i tyre (Smith, 2002, Costello, 1984, të gjitha sipas Kovačić dhe Čulum, 2015). Kovačić dhe Čulum (2015: 25-26) e përshkruajnë punën me të rinjtë si "proçes i planifikuar dhe i organizuar i zhvillimit individual dhe social të një të riu, d.m.th. fuqizimi i të rinjve në zhvillimin personal, ndërtimin e raporteve ndërpersonale dhe gjithëpërfshirjen e pjesëmarrjen aktive në shoqëri, të cilat bazohen në një partneritet dhe qasje miqësore, që u mundësojnë të rinjve të jenë themelues të barabartë të këtij proçesi".



Edhe pse fokusi tek të rinjtë dhe zhvillimi personal janë tipare të punës sociale dhe socio-pedagogjike, dallimet janë të dukshme për faktin se këto forma të punës me të rinjtë lidhen me kompetencat profesionale të dy profesioneve (punonjës socialë dhe pedagogë socialë/ edukatorë socialë) të cilat zakonisht kanë të bëjnë me punën profesionale me të rinjtë e rrezikuar apo me parandalimin e rrezikut, dhe dallimi është i dukshëm edhe në mënyrën e përfshirjes dhe pjesëmarrjes vullnetare në fillim.

Puna me të rinjtë nënkupton gjithmonë përfshirjen vullnetare të të rinjve (Ord, 2009, sipas Kovačić dhe Čulum, 2015: 25–26). Aktivitetet për të rinjtë brenda institucioneve mund të jenë të hapura për përfshirje vullnetare, si këshillimi i të rinjve, por shpesh ato nuk janë vetëm vullnetare, por të rinjtë inkurajohen të përfshihen. Për më tepër, puna me të rinjtë, për shkak të fazës zhvillimore në të cilën ndodhen, përfshin një segment të caktuar të pavullnetshmërisë. Në punën sociale dhe socio-pedagogjike, aktivitetet e orientuara kah të rinjtë mund të artikulojnë nga sistemi i drejtësisë dhe mirëqenies sociale dhe kështu të rinjtë mund të inkurajohen për t'u përfshirë, ndërsa në punën me të rinjtë, ata përfshihen vullnetarisht që në fillim (Dunne et al., 2014 sipas Kovačić dhe Čulum 2015: 34).

Dallimi i dytë ka të bëjë me objektivat e punës, ku me anë të punës për të rinjtë, i riu vendos objektivat dhe fushat në të cilat ai/ajo dëshiron të zhvillohet dhe forcohet personalisht/në aspektin social. Përkundrazi, kur institucionet përfshihen në punën me të rinjtë, nga këto institucione priten disa objektiva. Arritjet arsimore priten nga kurrikulat arsimore, ndërsa mirëqenia sociale dhe gjyqësori priten të arrijnë objektivat që lidhen me ndryshimin e sjelljeve kriminale dhe të rrezikshme dhe parandalimin e rreziqeve dhe konflikteve të ardhshme me ligjin.

Programi arsimor joformal i paraqitur përmes këtij udhëzuesi qëndron midis punës formale profesionale socio-pedagogjike me të rinjtë që janë identifikuar në rrezik të zhvillimit të problemeve të sjelljes, përfshirë ata që janë pjesë e institucioneve gjyqësore dhe të mirëqenies sociale dhe ata të punës arsimore joformale me të rinjtë. Të rinjtë do të ftohen të bashkohen vullnetarisht, por procesi ndonjëherë do të zhvillohet brenda institucionit dhe me të mitur ose të rinj që janë pjesë e institucionit. Megjithatë, puna mund të përfshijë edhe të rinjtë me probleme të sjelljes, të cilët qëndrojnë jashtë institucioneve, kur është e mundur.

Gjithashtu, fusha e zbatimit të Programit Y+ është fuqizimi dhe zhvillimi i shëndetshëm i të rinjve. Programi synon ndikimin transformues tek të rinjtë në rrezik, sepse i inkurajon ata që të vënë në dyshim stereotipet, paragjykimet dhe normat e tyre gjinore dhe sociale dhe të ndryshojnë sjelljen e tyre për aq sa mund të çojë në pasoja dhe rreziqe të dëmshme, d.m.th. në pjesën që mbështet dhe përjetëson dhunën.

2.Rëndësia e një qasjeje kritike ndaj normave dhe stereotipeve gjinore gjatë punës me të rinjtë e rrezikuar

Shoqëria shpesh pranon se të rinjtë janë autorë të dhunës ndaj të rinjve të tjerë, vetes dhe grave, pa vënë në dyshim socializimin dhe ndikimet që i çojnë të rinjtë drejt sjelljeve të tilla (CARE International Ballkan, 2016).

Në këtë program, ne i qasemi në mënyrë kritike normave dhe stereotipeve gjinore, pikërisht për të ndryshuar modelet e vendosura që çojnë në rezultate të padëshirueshme si p.sh.: më shumë të rinj që kryejnë krime, më shumë të rinj që përfshihen në incidente dhe sjellje të dhunshme dhe më shumë të rinj që përfshihen në dëmtim të shëndetit dhe cilësisë së jetesës dhe shpesh në sjellje të dënueshme (abuzimi me substanca narkotike, vënia e basteve dhe bixhozi, ngarja e makinës nmënyrë të rrezikshme dhe kundërvajtje në trafik, etj.) dhe kështu kemi një numër më të madh të të rinjve dhe të rejave në institucionet arsimore dhe penale.

Është e rëndësishme të shihet se si socializimi i të rinjve dhe të rejave ndikon në sjelljen e tyre dhe në mënyrën se si të rinjtë dhe të rejat sillen në përputhje me pritshmëritë e imponuara. Normat e ngurta gjinore në socializim mund të bëjnë që të rinjtë dhe sidomos djemtë të mos jenë në gjendje të shprehin ndjenjat e tyre, më rrallë të kërkojnë ndihmë dhe zgjidhin konfliktet me dhunë. Të gjitha këto janë të zakonshme në mesin e autorëve të rinj të krimeve dhe kundërvajtjeve. Prandaj, qëllimi i këtij programi është të njohë stereotipet gjinore dhe ndikimin e tyre në shfaqjen e sjelljeve të dhunshme dhe të rrezikshme, të përshtasë modelet e sjelljes jo të dhunshme, të mësojë të menaxhojë emocionet, të mbështesë diversitetin dhe të inkurajojë të menduarit kritik.

Gjatë historisë, aktivitete të ndryshme kanë synuar të luftojnë pabarazinë gjinore, por këto aktivitete kanë patur për qëllim kryesisht fuqizimin e grave. Megjithatë, sot ato njihen gjithandej, por pa ndikim të mjaftueshëm në arsim dhe socializim, se nuk do të kishte rezultate të mëdha në përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së grave apo burrave pa qenë të rinjtë (djem), baballarët dhe burrat e të gjitha moshave që të kontribuojnë aktivisht në këtë proces.

Përveç përpjekjes për të luftuar pabarazinë gjinore, ne nuk duam një sistem që krijon pabarazi gjinore, ndaj ne kërkojmë drejtësi gjinore. Ndryshe nga barazia gjinore, drejtësia gjinore artikulon një qasje feministe që shkon përtej kërimit të një hiseje të drejtë të sistemit/pushtetit ekzistues që ka shkaktuar problemet aktuale. Drejtësia gjinore kërkon të ndryshojë këtë sistem (Terry, 2009). Programi i konceptuar në këtë mënyrë fuqizon të rinjtë që të arrijnë potencialin e tyre të plotë pavarësisht nga normat dhe paragjykimet e imponuara gjinore dhe i mbështet ata të bëhen aleatë për një shoqëri më të drejtë (CARE International Ballkan, 2016).

Normat gjinore kanë ndikim të fuqishëm në formësimin e identitetit të të rinjve dhe mund të kontribuojnë në rritjen e ekspozimit të të rinjve ndaj sjelljeve të rrezikshme. Qasjet transformuese gjinore përfshijnë programe ose ndërhyrje që u krijojnë të rinjve mundësi individuale për t'u përballur me rolet gjinore stereotipike gjinore, për t'i transformuar barrierat në mundësi, për të promovuar ndërveprimet pozitive sociale bazuar në barazinë e të gjithë të rinjve, me fokus të veçantë tek vajzat dhe gratë (Health Communication Capacity Collaborative, 2014).

Ky program ka fillimisht për qëllim të preki të rinjtë me rrezik në zhvillimin e problemeve të sjelljes, dhe të rinjtë në rreziqe që lidhen me mjedisin familjar, si dhe të rinjtë e përfshirë nën trajtimin e institucioneve nga sistemi i mirëqenies sociale apo sistemi i drejtësisë.

Sa i përket pjesëmarrësve të përfshirë, është e rëndësishme të identifikohen rrethanat dhe përvojat jetësore që mund të jenë ose të mos jenë të pranishme në disa prej tyre gjatë adoleshencës, në mënyrë që këto përvoja dhe rrethana të merren parasysh dhe të përfshihen gjatë procesit të të nxënimit.

Në vijim janë paraqitur disa përvoja dhe rrethana që kemi identifikuar deri tani gjatë punës sonë me të rinjtë me probleme të sjelljes, të cilat janë të rëndësishme të merren parasysh. Në punën në grup me të rinjtë e rrezikuar, vështirësitë në të nxënë dhe përvojat negative me sistemin arsimor formal mund të jetë më të pranishme se sa tek popullsia e përgjithshme e të rinjve. Prandaj, pjesëmarrësit mund të tregojnë rezistencë ndaj teknikave dhe metodave që përdoren në sistemin e arsimit formal. Kështu që, lehtësuesit e grupeve individuale mund të shohin se ato prezantime, rishikime të teorive dhe modeleve, konceptet dhe frazat më komplekse, të nxënimit deduktiv nga e përgjithshmja në atë më specifike, fletët e punës, leximi i teksteve, shprehja me shkrim etj. mund të prodhojnë mosinteresim apo edhe rezistencë të të rinjve për të marrë pjesë në punën në grup. Nëse ndodh kjo, ne mund t'i përshtatim metodat dhe qasjet në atë mënyrë që metodat e përdorura në arsimin formal të përdoren sa më pak. Nëse grupi përfshin pjesëmarrës me vështirësi në të lexuar dhe në të kuptuar, atëherë është e rëndësishme që materialet të përshtaten sa më shumë, psh: që video mund të përdoret në vend të tekstit të shkruar, shprehja verbale e mendimeve në vend të shkrimit të fletëve të punës dhe diskutimet ose loja në role në vend të skenarit/shkrimit të komedisë, etj.

Të rinjtë për të cilët synohet ky program mund të kenë përvoja më të shpeshta dhe më të forta me dhunën në krahasim me bashkëmoshatarët e tjerë, nga të tri pozicionet:

- › **si persona që janë sjellë dhunshëm,**
- › **si të mbijetuar të dhunës, dhe**
- › **si vëzhgues të dhunës.**

Në situata të tilla të ekspozimit të lartë ndaj dhunës, qëndrimet e të rinjve për pashmangshmërinë dhe justifikimin e dhunës mund të jenë më të pranishme. Lehtësuesi(t) e aktiviteteve grupore të pamësuar për të punuar me këtë kategori mund të befasonen nga qëndrimet dhe reagimet që dalin nga këto qëndrime dhe mund të kenë vështirësi për t'u përballur me to. Një sfidë shtesë e punës me të rinjtë që kanë qëndrime që justifikojnë dhunën dhe/ose stereotipet e dëmshme sociale dhe e shohin atë si të pashmangshme, është se qëndrimet dhe vlerat e njerëzve që punojnë me të rinjtë janë të ndryshme prej qëndrimeve dhe vlerave të paraqitura nga ky grup të rinjsh. Kështu, lehtësuesit mund të ndihen të prekur nga justifikimi i roleve stereotipike gjinore ose dhunës deri në nivelin që pozicionet e tilla mund të vënë në pikëpyetje përvojën e tyre të mirëqenies dhe sigurisë.

Lehtësuesit duhet të jenë të përgatitur të respektojnë përvojat dhe këndvështrimet e ndryshme, të cilat shpesh lindin pikërisht nga rrethana specifike gjatë rritjes dhe jetës. Më pas lehtësuesit sfidohen të përipiqen të kuptojnë pikëpamjet e këtyre të rinjve, ndërsa në të njëjtën kohë përipiqen të inkurajojnë të kuptohen efektet e dëmshme të dhunës për të gjithë njerëzit, t'u mësojë atyre metoda të tjera të zgjidhjes së konflikteve dhe të hapin perspektiva të reja për dhënien e mundësive ku dhuna nuk duhet të jetë pjesë e jetës së tyre në të ardhmen.

Përvoja e të jetuarit në kushte ku rregullat janë strikte, të dhëna dhe të vendosura më parë, nga ku të rinjtë nuk do të mund të ndikojnë në to, siç është rasti i të jetuarit në një institucion, mund të çojë në një qëndrim të theksuar se rregullat janë të padrejta dhe/ose të panevojshme. Kjo pastaj si pasojë çon në testime më të shpeshta të kufijve dhe në qasje kreative ndaj mënyrave të shkeljes së këtyre rregullave për të luftuar për një pjesë të autonomisë dhe lirisë.

Duhet të merret parasysh se disa përvoja mund të mbështesin pikëpamjen që shfaqja e emocioneve, shqetësimeve dhe dobësive është një formë e shfaqjes së të metave, për të cilat ata mund të nënçmohen në mjedisin jashtë grupit të tyre. Për këtë arsye, ata mund t'i mbulojnë emocionet me humor ose zemërim, gjë që në asnjë mënyrë nuk nënkupton se nuk ka proces mësimor. Procesi mësimor potencialisht do të zhvillohet në nivelin e brendshëm të individit dhe ai ose ajo mund të mos ketë nevojë ta ndajë atë me grupin.

Qasjet dhe metodat që mund të ruajnë motivimin për pjesëmarrje apo ndryshim, dhe të kenë efekt stimulues e fuqizues tek të rinjtë në institucionet arsimore apo institucionet e mirëqenies sociale janë marrë nga metodologjia e edukimit joformal.

Është e rëndësishme të fillohet nga njohja me grupin, nevojat, interesat dhe mundësitë e tyre, si dhe nga krijimi i një atmosfere të sigurtë, pranimit dhe respektit, të cilat do të shpjegohen më hollësisht në tekstin vijues.



3. Roli i arsimit joformal në punën me të rinjtë e rrezikuar

Edhe pse të rinjtë ndonjëherë lidhjet e para i kanë me arsimin formal, duhet theksuar se qëllimi parësor i përfshirjes së të rinjve në forma joformale të arsimit është edhe të mësuarit, d.m.th. zhvillimi i aftësive dhe kompetencave. Në këtë kuptim, të mësuarit përfshin jo vetëm procesin formal të arsimit, por edhe zhvillimin e njohurive, aftësive, qëndrimeve dhe vlerave që do ta përgatisin një person për të marrë pjesë aktive në shoqëri, duke u kujdesur për mirëqenien e vet, mirëqenien e të dashurve të tyre, por edhe mirëqenien e komunitetit. Nëse një i ri nuk kujdeset për veten apo të tjerët dhe nuk zgjedh sjellje të pranueshme shoqërisht, të mësuarit mund të inkurajojë zhvillimin e shkathtësive sociale dhe emocionale dhe zgjedhjen e sjelljeve më të pranueshme shoqërore.

Qasjet e punës me të rinjtë në rrezik duhet të synojnë njohjen e pikave të tyre të forta dhe fuqizimin e tyre për të ndryshuar, duke u kujdesur më mirë për shëndetin dhe mirëqenien e tyre, duke ushqyer marrëdhëniet e ngushta dhe duke u kujdesur për mjedisin. Gjithashtu, procesi i të nxënimit me të rinjtë në rrezik synon të zhvillojë aftësitë e tyre sociale dhe modelet e sjelljeve jo të dhunshme.

Arsimi joformal zhvillohet përmes punës në grup në të cilën mund të përdorim metoda dhe qasje të ndryshme, të gjitha këto do t'i përshkruajmë më poshtë duke analizuar përparësitë dhe sfidat e tyre.



Të nxënit nga përvoja

Të nxënit nga përvoja përkufizohet si procesi i transformimit të vazhdueshëm të përvojës (Kolb, 1984). Një mësim i tillë merr parasysh përvojat e pjesëmarrësve, jep hapësirë për përvoja të reja dhe për reflektim mbi përvojat dhe të nxënit që rrjedh prej tyre. Një mësim i tillë inkurajohet nga ndërveprimi me mjedisin dhe rezultati mund të jetë, njohuri të reja në botë që mund të sjellin mendime dhe sjellje të reja. Diskutimet në grup për një temë të caktuar mund të jenë aktivitet që stimulon procesin e të nxënit nga përvoja. Të nxënit nga përvoja në kushte grupi u mundëson anëtarëve të grupit të mësojnë nga përvojat e tyre, si ajo e mëparshme (para grupit) ashtu edhe nga ajo përvojë që e fitojnë në grup. Me një mësim të tillë, anëtarët kanë ndikim më të madh në zgjedhjen e objektivave të tyre dhe të grupit. Mënyra e komunikimit ndërmjet anëtarëve, rolet që ata luajnë në grup, hapja dhe siguria në grup, si dhe përvojat e tjera të përbashkëta, janë jashtëzakonisht të rëndësishme dhe për këtë arsye shpesh përfaqësojnë përmbajtjen e punës në grup (tema e takimit). Lehtësuesi është më pak aktiv, ndjek më shumë ritmin dhe nevojat e grupit dhe krijon hapësirë që anëtarët të udhëheqin dhe të jenë aktivë.

Një metodë shtesë që është e mirë ose e këshillueshme për t'u përdorur në kohën kur brenda grupit është arritur siguria dhe besimi është të nxënit përmes dialogut. Dialogu përfshin shkëmbimin e ideve, përvojave, qëndrimeve dhe besimeve. Dialogu zhvillon aftësi sociale, ndjeshmëri dhe respekt për diversitetin, vetëm kur zhvillohet në mënyrë të respektueshme dhe gjithëpërfshirëse. Kur atmosfera në grup dhe niveli i besimit është i tillë që pjesëmarrësit janë të gatshëm të bëjnë përpjekjet e nevojshme për të dëgjuar dhe kuptuar në mënyrë aktive pozicione të ndryshme, madje edhe për ato me të cilat nuk pajtohen.

Të nxënit bashkëpunues

Të nxënit bashkëpunues i referohet të nxënit përmes ndërveprimit, komunikimit dhe bashkëpunimit ndërmjet pjesëmarrësve të procesit. Kjo metodë, pavarësisht nga përmbajtja e saj, çon në forcimin e shkathtësive të komunikimit dhe inkurajon një qasje të përbashkët për zgjidhjen e detyrave. Në të njëjtën kohë, ai kërkon më shumë komunikim në lidhje me ndarjen e detyrave dhe sfidat e pjesëmarrësve të procesit për të njohur përpjekjet dhe kontributin e secilit, ose mungesën e përpjekjeve.

Të nxënit nga vëzhgimi dhe zgjidhja e problemeve

Kjo i referohet nxitjes së kuriozitetit natyror dhe shtrimit të pyetjeve për të cilat vetë pjesëmarrësit më pas kërkojnë përgjigje. Ai forcon shkathtësitë kërkimore, të menduarit kritik dhe shkathtësitë për analizë të të dhënave, të cilat më vonë mund të aplikohen në fusha të ndryshme të jetës. Për shembull: për analizën kritike të stereotipeve gjinore në mjedis ose analizën kritike të përmbajtjes së mediave dhe njohjen më të mirë të mediave dhe informimit.

Në kushtet e punës në grup, mënyra të ndryshme të të nxënit kanë përparësitë e tyre dhe me një planifikim të mirë mund të përdoren të kombinuara në të njëjtin program pune në grup, madje edhe gjatë të njëjtit takim në grup.

Të nxënit e strukturuar përfaqësohet mirë nga puna në grup, që do të thotë se procesi i punës në grup është planifikuar paraprakisht në detaje, mundëson lidhjen e thjeshtë dhe logjike të objektivave (individuale dhe grupore) dhe përmbajtjen e punës.

3.1. Qasjet që fuqizojnë dhe motivojnë pjesëmarrjen dhe ndryshimin

Në procesin e përgatitjes, ekspertët shpesh shqetësohen se **si t'i motivojnë të rinjtë të marrin pjesë** në përvojën e "të nxënit/mësimin". Prandaj, në pjesës e mëposhtme do t'i kushtojmë vëmendje motivimit dhe inkurajimit të tij, për të marrë pjesë në aktivitete psikosociale, d.m.th. në format joformale të arsimit.

Colby dhe Damon (1992) përshkruajnë potencialin transformues të motivimit, d.m.th. procesi përmes të cilit përfshirja e një të riu mund të stimulohet nga stimuj të jashtëm, por personi mund të ndiejë edhe kënaqësi të brendshme gjatë pjesëmarrjes, gjë që më pas mund të bëhet motivimi parësor për pjesëmarrje të mëtejshme.

Ballard (2014) identifikon katër kategori motivimi që nuk janë të ndara në mënyrë strikte nga njëra-tjetra, domethënë ato mund të ndërthuren dhe të ndryshojnë me kalimin e kohës.

- › **Arsyeja personale** i referohet angazhimit në aktivitete të cilat të rinjtë i kanë pasion, të cilat i konsiderojnë të rëndësishme dhe përmes së cilave duan të arrijnë ndryshimet që ata i konsiderojnë pozitive.
- › **Besimet** i referohen një forme motivimi në të cilën i riu e konsideron të rëndësishme pjesëmarrjen aktive dhe aktivizmin, d.m.th. kur i riu ka vlera dhe besime të rëndësishme të veprave pozitivisht në komunitetin e tij dhe të jetë i/e përfshirë në të.
- › **Qëllimi personal** i referohet dëshirës së një të riu për rritje dhe zhvillim personal, avancim, mësimin e një aftësie të caktuar.
- › **Përgjigja ndaj thirrjes** i referohet përfshirjes së të rinjve pasi dikush i fton ata të përfshihen, pavarësisht nëse është një bashkëmoshatar, mik apo i rritur.

Lidhur me barrierat për përfshirjen e të rinjve, Ballard (2014) identifikon barrierat personale dhe sistematike. Barrierat personale njihen tek të rinjtë që nuk kanë interesim të shprehur për përfshirje, mendojnë se nuk mjaftojnë për të ndryshuar diçka ose kanë parime për mospërfshirje. Nga ana tjetër, barrierat sistematike përfshijnë barrierat me të cilat përballen të rinjtë për shkak të qasjes së vështirë, mungesës së mundësive për përfshirje, mungesës së kohës, burimeve dhe njohurive. Këto arsye i bëjnë të rinjtë të besojnë se përfshirja e tyre është e kotë, e parëndësishme dhe që nuk do të ndryshojë asgjë.

Tashmë është përmendur se të nxënit e strukturuar mundëson **lidhjen e objektivave të grupit me objektivat individuale të secilit anëtar** dhe kjo lidhet drejtpërdrejt me motivimin. Nëse një i ri ka një ndjenjë individuale se pse është e rëndësishme të marrë pjesë në program, ai do të motivohet për të marrë pjesë. Kjo mund të arrihet edhe para se t'i bashkohet programit të punës në grup, kur paraqitet qëllimi dhe objektivi i programit në grup. Kjo ndihmohet nga qëllime dhe objektiva të përcaktuara qartë (të cilat thjesht formulohen dhe përshtaten me anëtarët e grupit/programit).

Për më tepër, me rritjen e motivimit për të marrë pjesë, zvogëlohet pasiguria se çfarë do të ndodhë në grup. Kjo mund të arrihet duke informuar për strukturën dhe përmbajtjen e punës, duke përcaktuar rregullat e punës dhe duke harmonizuar pritshmëritë nga kjo përvojë. Prandaj, le të fillojmë në rendin e mëposhtëm:

Informimi mbi strukturën dhe përmbajtjen e punimit: Informimi bëhet përpara se të fillojë programi. Është e rëndësishme të planifikohet paraprakisht dhe të përfshijë:

- › informimin për qëllimet dhe objektivat e programit;
- › për kë është menduar programi;
- › si do të zbatohet programi, dhe
- › cila do të jetë përmbajtja e punimit.

Është e mundur që informimi të zbatohet individualisht me secilin pjesëmarrës të mundshëm në program. Përparësia e kësaj qasjeje: është e mundur të përcaktohen objektivat individuale për pjesëmarrjen në program.

Përcaktimi i rregullave të punës: Zë vend në takimin e parë të grupit të zbatimit të programit të arsimit joformal, i vendosur në një kontekst grupi. Vendosja e rregullave lehtëson përfshirjen në grup, d.m.th. mundëson përfshirjen e të gjithë anëtarëve të grupit në kushte të barabarta dhe krijimin e një mjedisi të sigurt në të cilin ata e dinë se cilat janë sjelljet e dëshirueshme. Rregullat janë deklarata pozitive që përshkruajnë sjelljet e dëshirueshme në mjedis dhe/ose situatë specifike. Kjo deklaratë përbëhet nga një përshkrim i sjelljeve të dëshirueshme; nevoja që plotësohet nga sjellja e përmendur dhe pasojat që do të vijnë në rast të shkeljes së një rregulli. Rregullat duhet të bien dakord dhe të vendosen së bashku me anëtarët e grupit.

Proçesi i krijimit të rregullit përfshin hapat e mëposhtëm:

Hapi I - Lehtësuesi shpjegon nevojën për rregulla dhe përfitimet që anëtarët e grupit do t'i kenë individualisht dhe bashkërisht nëse bien dakord për rregullat. Shpjegimi bazohet në idenë e sigurisë, një mjedis më të këndshëm, mundësinë e komunikimit të ndërsjellë me respekt dhe parashikueshmëri të sjelljes së anëtarëve të tjerë në situata grupi.

Hapi II - anëtarët sugjerojnë rregullat që do t'i dëshironin t'i kishin në grup, domethënë sugjerojnë rregulla të mundshme. Lehtësuesi nuk i kufizon ata në propozimin, por u ndihmon duke i përshkruar rregullat për të cilat ai beson se grupi ka nevojë (mund të mbështetet në përvojat e mëparshme). Propozimi mund të bëhet sipas parimeve të metodës "brainstorming" (hedhja e ideve) – që do të thotë se çdo rregull që propozohet në këtë fazë vetëm shkruhet, pa shpjegime të veçanta. Kur nuk ka më ide, lehtësuesi dhe grupi përqendrohen në përcaktimin se cilat rregulla do të "jetësohen" në grup. Në të njëjtën kohë, është thelbësore që rregullat të cilat pjesëmarrësit e programit mund t'i identifikojnë për fitime si dhe ato tek të cilat është e mundur të gjenden pasoja logjike, në rast se anëtarët e grupit nuk i përmbahen këtij rregullit "të jetësimit".

Hapi III - duke rënë dakord për mënyrën në të cilën rregullat dhe pasojat do të bëhen/mbeten një histori grupore (qoftë duke shkruar, ose duke rënë dakord për ndonjë mënyrë tjetër të mbajtjes së rregullave). Konsistenca në zbatimin e pasojave, në rast të shkeljes së rregullave, është një aspekt kryesor i vendosjes së rregullave. Në fillim të programit në grup, përgjegjësia për këtë pjesë do të jetë e lehtësuesit, por në grupe, me kalimin e kohës, këtë pjesë mund ta marrin përsipër anëtarët e grupit. Është e rëndësishme që lehtësuesit të flasin me pjesëmarrësit nëse rregullat nuk respektohen gjatë punës në grup. Të punosh së bashku me pjesëmarrësit, gjë që kuptohet dhe të pranohet nga të gjithë, nënkupton sigurinë, jodhunën dhe respektimin e dinjitetit të çdo personi si kusht dhe mbetet një mjet kyç në kohë të përçarjeve.

Përcaktimi i kufijve: është e nevojshme që lehtësuesi të përcaktojë kufijtë, d.m.th. sjelljet e padëshiruara që nuk do të tolerohen në grup. Sjelljet e tilla zakonisht përfshijnë forma të ndryshme të sjelljes së dhunshme, si fyerje, tallje, thirrje me emra nënçmues, përleshje, sulme fizike, etj. Zakonisht ato janë të përcaktuara tashmë në nivelin e institucionit ku mund të zbatohet programi dhe për këtë arsye është e nevojshme që lehtësuesit të informohen për rregullat e organizatës dhe të jenë në dijeni se ata dhe përdoruesit duhet në çdo kohë të respektojnë rregullat në kontekstin më të gjerë në të cilin zbatohet programi.

Përcaktimi i pritshmërive të grupit: pritshmëritë diskutohen në takimin e parë dhe përmes këtij diskutimi është e mundur që nga të rinjtë të mësohet se çfarë pritet në nivelin e përmbajtjes dhe kështu të përshtatet vetë programi, ose të drejtohen diskutimet gjatë punës në drejtimin e dëshiruar. Megjithatë, është po aq e rëndësishme që të fitohen njohuri për pritshmëritë që lidhen me nivelin e proçesit, d.m.th. niveli i pjesëmarrjes, llojet e aktiviteteve në të cilat ata dëshirojnë të marrin pjesë. Diskutimi i pritshmërive mundëson që të respektohet këndvështrimi i përdoruesit. Nëse lehtësuesi sqaron që në fillim se disa pritshmëri nuk do të përmbushen, anëtarët nuk do të zhgënjehen ose do të jenë më pak të zhgënjyer nëse vetë pjesëmarrja nuk i përshtatet këndvështrimit të tyre.

3.2. Puna në grup duke përfshirë anëtarët që ndihen nën presion për të marrë pjesë në punën në grup

Për t'ju njohur me disa aspekte të mosgatishmërisë për pjesëmarrje, imagjinoni se ju duhet të takoheni rregullisht dhe të shoqëroheni me dikë me të cilin nuk do të dëshironit të rrin. Pasi ta keni imagjinuar këtë situatë, e cila përsëritet rregullisht, përpiquni t'u përgjigjeni pyetjeve të mëposhtme:

- › Për çfarë arsye do ta bënit gjithsesi/përsëri?
- › Për çfarë arsye do ta bënit përsëri dhe përsëri?
- › Si do të vetërregulloheshit?
- › Çfarë do të bënit për ta bërë sa më të lehtë gjithë procesin e shoqërimit dhe takimit me atë(a) person(a)?

Duke iu përgjigjur këtyre pyetjeve, ju mund të kuptoni, të paktën pjesërisht, këndvështrimin e një personi i cili në një farë mënyre ndihet i detyruar për të marrë pjesë në një formë të arsimit joformal ose në një program grupor. Ju, si lehtësues i arsimit joformal, mund të mos i keni detyruar të marrin pjesë në këtë program, sepse ai përfshin vullnetarizmin. Megjithatë, përvoja me institucione të mirëqenies sociale, për shkak të problemeve të sjelljes, mund t'i detyrojë ata të marrin pjesë në këtë dhe programe ose aktivitete të ngjashme. Në çdo rast, është pozitive apo fuqizuese që anëtarët jovullnetarë, d.m.th. ata që ndiejnë presion të jashtëm për të marrë pjesë në një program pune në grup/arsim joformal, mund të përfitojnë nga pjesëmarrja. Për ta arritur këtë, është e rëndësishme të pranohet detyrimi i mundshëm për të marrë pjesë, të cilin e ndiejnë anëtarët.

Nocioni i jovullnetarizmit gjithmonë lidhet me një perspektivë të caktuar për programin/shërbimin e ofruar:

- › ata nuk kanë kërkuar të përfshihen;
- › mundësia e refuzimit për të marrë pjesë është e kufizuar;
- › nuk mund të vendosin për llojin e programit;
- › nuk mund t'ju zgjidhnin si lehtësues i programit;
- › frika nga e panjohura;
- › frika nga vlerësimi dhe zbulimi/shpalosja gjatë procesit të grupit;
- › dyshimet nëse ndryshimi është i mundur ose kanë për detyrë që ta ndryshojnë.

Një situatë e tillë mund të shkaktojë rezistencë në punë. Në punën në grup, veçanërisht në punën me të rinjtë me probleme të sjelljes, rezistenca mund të shfaqet përmes një sërë sjelljesh: hesh-tje, injorim, braktisje e procesit në grup, provokim, banalizim, devijim nga tema, zemërim se ata duhet të jenë këtu, zhvlerësim i lehtësuesve, shmangie, sjellje keqpërshtatëse dhe shpërthime emocionale. Në këtë situatë, është thelbësore të kuptohet se rezistenca nuk është personale, por lind në ndërveprim dhe në një marrëdhënie. Kjo do të thotë që si lehtësues nuk mund të merrni përgjegjësinë nëse do të ketë rezistencë apo jo, por është e nevojshme të merrni përgjegjësinë për rezistencën që lind në grup. Vazhdimi i këtij teksti do të ndihmojë në krijimin e procedurave nëse ka rezistencë ndaj pjesëmarrjes në një grup ose proces grupi.

Pse ka rezistencë ndaj punës? Disa autorë (Levine, Schwartz, Van der Kolk) pajtohen se rezistenca është mbrojtës i një personi prej përvojave të pakëndshme ose të dhimbshme. Mund të ketë gjithashtu frikë nga dënimi. Nëse i qasemi rezistencës si fenomen që mbron dhe kujdeset për

një person dhe mirëqenien e tij, atëherë ka më pak gjasa që ajo të provokojë tek ne emocione zemërimi ose refuzimi. Në këtë mënyrë, ne mund t'i qasemi asaj duke respektuar të riun dhe kufijtë e tij personal dhe duke u përpjekur t'i ndihmojmë ata për të kuptuar se pse një përvojë e veçantë është e dhimbshme ose pse një përvojë e veçantë është e ndjeshme.

BURIMET E MOTIVIMIT TË ULËT TË ANËTARËVE (Willshire dhe Brodsky, 2001)

1. Përcaktimi i problemit

- ▶ për anëtarët me motivim të ulët, problemi kryesor mund të jetë pse ata duhet të marrin pjesë, por jo cilat aftësi t'i kenë/cilat qëndrime dhe besime t'i ndryshojnë

2. Pritshmëritë negative

- ▶ bazuar në përvojën e mëparshme, ata nuk besojnë se mund të mësojnë diçka të re në këtë formë të arsimit joformal/programit të punës në grup

3. Çështjet e pushtetit dhe kontrollit

- ▶ mosbalancimi i pushtetit midis anëtarëve dhe lehtësuesit të punës në grup bazohet në faktin se lehtësuesi di "çdo gjë" dhe anëtarët nuk dinë asgjë.

4. Karakteristikat e klientëve

- ▶ problemet e pranishme afatgjata, stilet joefektive të zgjidhjes së problemeve, problemet me autoritetet, problemet me krijimin e marrëdhënieve, turpi, frika nga humbja e respektit për të tjerët, etj.

5. Të tjera

- ▶ disa tipare të kulturës, familjes dhe marrëdhënieve me partnerin janë të rëndësishme.

Teoria e Vetëvendosjes, nga Ryan dhe Deci (2002), është shumë e dobishme në formimin e punës me një grup në të cilin ka anëtarë që rezistojnë të marrin pjesë. Sigurisht që është e këshillueshme që të njiheni me këtë teori të motivimit, por në këtë pjesë do të shohim vetëm implikimet e drejtpërdrejta në punën në grup. Teoria supozon se mjedisi mund të inkurajojë ose parandalojë motivimin për t'u përfshirë në lloje të caktuara të aktiviteteve, varësisht prej faktit nëse personi është i aftë të përmbushë nevojat themelore psikologjike (Deci dhe Ryan, 2002):

- › nevoja për autonomi - vetëorganizimi i sjelljes së vet në përputhje me përvojën e brendshme të vetvetes;
- › nevoja për kompetencë - një ndjenjë suksesi (efikasitet) dhe kontroll mbi mjedisin;
- › nevoja për lidhje - lidhje me persona të tjerë dhe grupe shoqërore.

Është e domosdoshme që lehtësuesi i programit të punës në grup të ketë parasysh se çdo anëtar i grupit duhet që gjatë pjesëmarrjes, në një aspekt të caktuar, të plotësojë tri nevojat e deklaruara - autonominë, kompetencën dhe koherencën. Këtu janë disa mënyra në të cilat kjo mund të arrihet, duke vënë në dukje se kjo është një fushë ku mund të jesh shumë inovativ dhe krijues.

Për të ndihmuar anëtarin e grupit **që të plotësojë nevojën për lidhje në grup**, lehtësuesi duhet të përfshijë çdo anëtar në grup duke: pranuar anëtarin e grupit, duke i kushtuar kohë atij/asaj, duke treguar kujdes dhe kuriozitet, duke e njohur atë, duke ditur se çfarë i ndodh atij/asaj çdo ditë (nga një takim në tjetrin), shpreh dashurinë, pëlqimin dhe mirëkuptimin, shijon sinqerisht kohën e kaluar me të, ndan burimet e veta, si: kohën, vëmendjen, energjinë,

interesat dhe mbështetjen emocionale. Është thelbësore që si lehtësues të kenë parasysh se duhet të bëheni anëtarë të rëndësishëm të grupit. Por e gjithë përgjegjësia nuk është mbi ju, është gjithashtu e mundur të lidhni anëtarët me anëtarë të tjerë të grupit, të njiheni me anëtarët, të inkurajoni mirëkuptimin dhe dashurinë e ndërsjellë për grupin si tërësi.

Për të plotësuar **nevojën për kompetencë**, është e nevojshme të sigurohet struktura e përmendur më parë, duke përshkruar se si anëtarët janë të informuar për programin e grupit, si vendosen rregullat në grup dhe si kontrollohen pritshmëritë. Përveç kësaj, nevoja për kompetencë plotësohet përmes inkurajimit, dhënies së komenteve, dhënies së këshillave dhe shkathtësive të mësimdhënies. Është thelbësore që përmbajtja e programit të jetë e pasur dhe interesante për pjesëmarrësit dhe që ata të dinë se si mund të përparojnë dhe të përfitojnë prej tij.

Nevoja për autonomi mund të arrihet kryesisht duke dëgjuar anëtarët, duke kuptuar këndvështrimin e tyre dhe duke i lejuar anëtarët e grupit që disa gjëra t'i bëjnë në mënyrën e tyre.

Këtu janë dhënë disa rekomandime se si të filloni kur në grup ka anëtarë që rezistojnë ose që janë të bindur se janë të detyruar të jenë në programin e grupit.

Para fillimit të punës në grup, është e rëndësishme që:

- › **Të përcaktoni se cilat nga rrethanat nuk do të jenë të mundura të diskutohen dhe negociohen** me anëtarët e ardhshëm të grupit, dhe rreth kujt duhet të arrihen marrëveshje dhe konsensus. Për shembull, është e nevojshme të sqarohet nëse ekziston mundësia e (mos)pjesëmarrjes, nëse pjesëmarrja është e detyrueshme, çfarë lloj pjesëmarrjeje pritet. Është e nevojshme të zhvillohen norma rreth nivelit të pritshëm të pjesëmarrjes (p.sh. ulja brenda një rrethi, jo jashtë tij; pjesëmarrja aktive në aktivitete; mundësia për të bërë një përjashtim një herë nga pjesëmarrja aktive në aktivitete).
- › **Të përcaktoni qartë të drejtat, zgjedhjet dhe pritshmëritë.** Për shembull, është e mundur që pjesëmarrësit të lejohen të zgjedhin përmbajtje individuale. Nëse lehtësuesi(t) pret(sin) sjellje kontradiktore, strategjitë efektive të përballimit mund të merren parasysh.
- › **Të identifikohen mekanizmat aktualë motivues.** Fillimisht është e rëndësishme të kemi parasysh se megjithëse individët nuk janë të motivuar në thelb për të marrë pjesë në një grup në fillim, thjesht përkatësia në një grup mund të jetë një mundësi për të ndikuar në motivimin e tyre.
- › **Të identifikohen shkathtësitë dhe njohuritë pozitive** që mund të mësohen përmes pjesëmarrjes në grup (p.sh. shkathtësitë e komunikimit dhe të bashkëpunimit), domethënë, para fillimit të grupit, duhet të mendoni për mënyrën e paraqitjes së idesë dhe qëllimin e grupit, ashtu që të jenë më tërheqëse për vetë anëtarët.

3.3. Filloni të punoni me një grup ku ka rezistencë ose disa anëtarë besojnë se janë të detyruar për të marrë pjesë në një program grupi

Grupet me anëtarë që janë të bindur se janë të detyruar të marrin pjesë në një program grupi zakonisht fillojnë me një lojë pushteti midis anëtarëve dhe lehtësuesve. Gjithashtu, anëtarët shpesh njihen me kufijtë, d.m.th. gjërat që nuk mund të negociohen, që në fillim. Qëllimi i takimit të parë duhet të jetë sqarimi i të gjitha mundësive, zgjedhjeve, pritjeve dhe kufizimeve. Është po aq e rëndësishme që anëtarët të lejohen të jenë të pavullnetshëm, duke pasur parasysh se prapa rezistencës shpesh fshihen frika, cenueshmëria dhe emocionet e ngjashme të pakëndshme dhe të dhimbshme.

Sugjerimi i përmbajtjes për takimin e parë:

- › një hyrje që sqaron elementet e punës dhe mjedisin e punës që mund ose nuk mund të negociohet, të cilat më pas mundësojnë pritshmëritë realiste të programit të grupit,
- › inkurajimi i zhvillimit të objektivave personale të anëtarëve dhe lidhjes së tyre me objektivat e grupit (objektivat e anëtarëve më së shpeshti do të lidhen me atë që duan të mësojnë ose zotërojnë në programin e grupit dhe që është e mundur të lidhen me objektivën e grupit),
- › negocimi i rregullave të sjelljes, dhe
- › përcaktimi i pritjeve për takimin e ardhshëm.

Puna pas angazhimit (marrëveshja)

Pasi të jeni pajtuar për metodat e punës, të keni pranuar vendime të panegociueshme dhe të keni përcaktuar objektivat individuale, mund të barazoni në një farë mase anëtarët e grupit që kanë dalë vullnetarë për t'u përfshirë me ata që ndiejnë presion të jashtëm për të marrë pjesë. Kështu, ju keni krijuar kushtet e punës mbi përmbajtjen e synuar, besimet dhe vlerat e anëtarëve. Aktivitetet e mëtejshme varen nga vetë qëllimi i grupit.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm që mund të ndikojë në motivimin e anëtarëve është mënyra se si drejtohet grupi, pra stili i udhëheqjes. Brown (2002) paraqet dy dimensionet e stilit të udhëheqjes – atë të orientuar nga detyrat dhe atë të orientuar nga marrëdhëniet. Liderët, stili i të cilëve është më i përqendruar në marrëdhënie, i nënvizojnë marrëdhëniet në grup, janë të interesuar për grupin, tregojnë interes për anëtarët e grupit. Udhëheqësit, stili i të cilëve është më i orientuar nga detyrat, i japin përparësi detyrës dhe aktiviteteve që grupi duhet të bëjë, sepse ata kryesisht orientohen nga arritjet dhe objektivat. Edhe pse në mënyrë intuitive mund të konkludohet se kjo është e rëndësishme kryesisht në grupet ku ka presion të jashtëm për të marrë pjesë, vetëtheksi vihet në stilin e orientuar nga marrëdhëniet. Megjithatë, është gjithashtu e rëndësishme të mos neglizhoni punën dhe detyrat. Anëtarët me presion të jashtëm për t'iu bashkuar grupit duhet të ndiejnë nëse pjesëmarrja është e përshtatshme për ta dhe kjo është e mundur vetëm duke e përmbushur detyrën dhe duke punuar në objektivat e grupit. I njëjti autor (Brown, 2002) thekson se nëse ka nivel jashtëzakonisht të ulët të gatishmërisë për të mësuar në një grup, duhet të sigurohet një mënyrë shumë e strukturuar e punës në të cilën udhëheqësi përcakton pjesën më të madhe të përmbajtjes dhe menaxhon pjesën më të madhe të ndërveprimeve. Nëse tek anëtarët e grupit rritet niveli i gatishmërisë për të mësuar, atëherë tek anëtarët e grupit mund të lihet një pjesë e përgjegjësisë, për të marrë më shumë iniciativë dhe pjesëmarrje aktive të anëtarëve.

3.4. Monitorimi dhe vlerësimi i Programit

Monitorimi dhe vlerësimi janë komponentë të rëndësishëm të programit dhe të domosdoshëm për programe të përgatitura dhe të zbatuara mirë. Përfitimet e monitorimit dhe vlerësimit të programit janë të shumëfishta dhe ju mundësojnë të mësoni si në vijim:


- › Sa kanë përfituar/përvetësuar pjesëmarrësit njohuri dhe shkathtësi?
- › Ku mund të futen risi në aktivitete, qasje dhe metoda që mund të çojnë në rezultate më të mira tani dhe në fazat e ardhshme të projektit?
- › Si të përcaktohen objektivat e qarta dhe të matshme apo më të qarta dhe më të matshme në nivel individual dhe grupor?
- › Çfarë mendojnë pjesëmarrësit për projektin/aktivitetet e zbatuara (si të mblidhen komentet)?

Monitorimi dhe vlerësimi i programit të grupit fillon në fazën e planifikimit. Kjo është arsyeja pse ky kapitull është në fillim të udhëzuesit, për të rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e krijimit të një metode vlerësimi përpara nisjes së programit me një grup përfituesish.

Për të sqaruar se çfarë është dhe çfarë përfshin vlerësimi, do të nisemi nga vetë përkufizimi i vlerësimit. Ai përfshin "klasa procedurash që synojnë të përcaktojnë rezultatet e arritura nga një aktivitet i planifikuar për të arritur një objektiv të rëndësishëm individual ose shoqëror" (Kulenovic, 1996). Vetë përkufizimi dikton që në krijimin e vlerësimit duhet "të fillohet" me objektivat e përcaktuara të programit, gjë që do ta bëjmë në këtë rast.

Për më tepër, është e rëndësishme të dallohet vlerësimi i procesit dhe vlerësimi i rezultatit. **Vlerësimi i procesit** përfshin monitorimin e zbatimit të punës në grup, d.m.th. i përgjigjet pyetjes nëse programi zbatohet sipas synimit. Për këtë qëllim, zbatimi i çdo takimi në grup monitorohet, pra mënyra se si punojnë lehtësuesit, kënaqësia e anëtarëve me takimet dhe marrëdhëniet në grup, pjesëmarrja në punën në grup, etj. **Vlerësimi i arritjes/rezultatit**, d.m.th. arritja e objektivave i referohet matjes së rezultateve të arritura apo nivelit të arritjes së objektivave. Ai synon të vlerësojë ndikimin e programit të grupit tek anëtarët e grupit. Prandaj, ai përfshin monitorimin e progresit të anëtarëve individualë dhe të grupit në tërësi në arritjen e objektivave.

Proçesi i vlerësimit fillon me përcaktimin e objektivave të programit të punës në grup. Hapi tjetër përfshin përcaktimin e treguesve që do të kontrollojnë objektivin e caktuar, dhe më pas përcaktimin e burimit të informacionit për të kontrolluar treguesit e përcaktuar (duke treguar hapat në skemë).



Plani i vlerësimit krijohet në bazë të objektivave të përcaktuara të programit. Si përmbledhje, ato janë:

- › Të jenë në dijeni dhe të analizojnë në mënyrë kritike stereotipet dhe paragjykimet gjinore dhe ndikimin e tyre në sjelljen e pabarabartë dhe kërcënuese (diskriminuese) karshi njerëzve në lidhje me gjininë;
- › Të rrisë vetëdijesimin për dëmet e të gjitha formave të dhunës, veçanërisht asaj mbi bazë gjinore, dhe të përmirësojë shkathtësitë e veprimit jo të dhunshëm,
- › Të inkurajojë zgjedhjen e sjelljes jo të dhunshme,
- › Të inkurajojë zhvillimin e qëndrimeve për drejtësinë gjinore

Treguesit për procesin e vlerësimit

1. Një cikël prej 12 punëtorish janë mbajtur sipas vazhdimësisë së planifikuar

2. Pjesëmarrësit janë të kënaqur me të gjitha aspektet e pjesëmarrjes në program (përmbytja dhe aktivitetet, atmosfera në grup, lidhshipi, kontributi personal)

3. Pjesëmarrësit janë të kënaqur me kohezionin dhe lidhjen e grupit

Treguesit e vlerësimit të performancës

4. Pjesëmarrësit janë në dijeni për ekzistencën e stereotipeve dhe paragjytimeve gjinore dhe ndikimin e tyre në sjellje.

5. Pjesëmarrësit kanë përmirësuar njohuritë për dëmet nga të gjitha format e dhunës dhe njohjen e dhunës mbi bazë gjinore

6. Pjesëmarrësit kanë përmirësuar shkathtësitë e tyre jodhunuese

7. Pjesëmarrësit mbështesin më shumë barazinë gjinore

Burimet e informatave për kontrollimin e treguesve

Raporti për zbatimin e ciklit të programit

Vlerësimi i kënaqësisë me pjesëmarrjen në një punëtori individuale

Pyetëtori përfundimtar për kohezionin në grup

Burimet e informatave për kontrollimin e treguesve

Shkalla GEM është aplikuar para dhe pas programit (në fillim dhe në fund të punëtorisë)

Shkalla GEM është aplikuar para dhe pas programit (në fillim dhe në fund të punëtorisë)

Shkalla GEM është aplikuar para dhe pas programit (në fillim dhe në fund të punëtorisë).
Ilustrimi i situatave me përshkrime të skenarëve potencialisht (jo)dhunues në fillim dhe në fund të programit (në fillim dhe fund të punëtorisë)

Shkalla GEM është aplikuar para dhe pas programit (në fillim dhe në fund të punëtorisë)

4. Rishikimi i punëtorive

Në vazhdim të udhëzuesit janë prezantuar 12 punëtori, ku secila prej tyre zgjat 60 minuta. Punëtoritë përshkruhen në një format konçiz ku tregohen aktivitetet e rekomanduara në fillim dhe në zhvillim e sipër. Secila punëtori përfundon me një përfundim që është i rëndësishëm për t'ua përcjellë pjesëmarrësve qoftë përmes diskutimit të lehtësuar, udhëzimit ose përmes ndonjë aktiviteti shtesë përmbyllës që do t'u përshtatet nevojave dhe disponimit të grupit.

Gjithashtu, në fund të çdo punëtorie është planifikuar një vlerësim i procesit dhe në takimin fillestar dhe përfundimtar vlerësimi të performancës i kushtohet më shumë kohë.

Arritjet e pritshme arsimore të pjesëmarrësve lidhen me faktin se pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- › shqyrtojnë në mënyrë kritike normat, stereotipet dhe paragjykimet gjinore dhe ndikimin e tyre në sjelljen e pabarabartë dhe kërcënuese ndaj njerëzve në lidhje me gjininë,
- › përshkruajnë dëmet e të gjitha formave të dhunës,
- › përshkruajnë format dhe dëmet nga dhuna mbi bazë gjinore,
- › zgjedhin modele të sjelljes jo të dhunshme,
- › advokojnë për barazinë gjinore dhe drejtësinë gjinore.



Punëtorja nr. 1

Le t'i vendosim rregullat tona

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › pjesëmarrësit dhe lehtësuesit – njohja me njëri-tjetrin
 - › marrëveshja për punën
 - › inkurajimi i dialogut të bazuar në respekt
- **Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:**

një shkop (mundësisht prej druri të gdhendur ose ndonjë shkop tjetër), një tabelë letre për prezantim (flipchart) dhe markera (stilolapsa), karrige të vendosura në rreth.

AKTIVITETET

- **1. Aktivitetet hyrëse për njohje dhe prezantimi i programit**

1.a Njohja e njëri-tjetrit

Kohëzgjatja: 7 minuta.

Objektivat: anëtarët e grupit dhe lehtësuesit po e njohin njëri-tjetrin, duke praktikuar rikujtimin e emrave të anëtarëve të grupit, duke inkurajuar bashkimin e grupit.

Zhvillimi:

Të gjithë pjesëmarrësit qëndrojnë në rreth. Secili pjesëmarrës duhet të prezantohet, me radhë një pjesëmarrës qëndron në mes të rrethit, e thotë emrin e tij/saj dhe thotë një mbiemër pozitiv që e përshkruan atë në mënyrë pozitive, duke filluar me shkronjën e parë të emrit të tyre (p.sh. Ana, ambicioze). Çdo pjesëmarrës në vijim përsërit emrat dhe mbiemrat e secilit pjesëmarrës përpara tij/saj dhe më pas e thotë emrin dhe mbiemrin e tij/saj. Për ta filluar lojën, është mirë që lehtësuesit fillimisht të prezantohen me emër dhe mbiemër në mënyrë që ta afrojnë lojën me pjesëmarrësit e tjerë. Pjesëmarrësit e tjerë bashkohen kur të jenë gati.

1.b Prezantimi i programit

Kohëzgjatja: 3 minuta.

Objektivat e aktivitetit fillestar: njohja e pjesëmarrësve me qëllimin dhe objektivat e programit.

Zhvillimi:

Lehtësuesit prezantohen shkurtimisht, tregojnë se çfarë bëjnë zakonisht, në cilën organizatë punojnë dhe paraqesin temat që do të trajtohen dhe diskutohen gjatë takimit, por me fjalë që pjesëmarrësit i kuptojnë. Shpjegojuni atyre se temat që do t'i trajtoni janë pritshmëritë sociale, shprehja e ndjenjave, pranimi i diversitetit dhe zgjidhja e konflikteve pa dhunë.

Ju mund t'u tregoni pjesëmarrësve si në vijim:

Punëtoritë tona janë një program edukativ në grup i punës me të rinjtë. Në punëtoritë tona, ne krijojmë hapësirë të sigurt për të reflektuar në mënyrë kritike mbi normat sociale, që do të thotë të jesh burrë apo grua dhe të krijosh një version më të shëndetshëm të vetes. Gjatë javëve të ardhshme, ju do të rimendoni supozimet tuaja për rolet mashkullore dhe femërore që mund të mos i vini re apo t'i sillni ndër mend. Do ta keni gjithashtu mundësinë të diskutoni tema që zakonisht nuk mund t'i diskutoni. Grupet tona janë krijuar jo vetëm për t'ua paraqitur një sfidë, por edhe për t'u ofruar mbështetje atëherë kur ju nevojitet. Ky program do t'ju ndihmojë të mësoni të mendoni në mënyrë kritike për normat e imponuara, të shprehni ndjenjat tuaja, të zgjidhni konfliktet në mënyrë jo të dhunshme, dhe të pranoni dallimet dhe mendimet e ndryshme.

○ 2. Aktivitetet qendrore

2.a Aktiviteti: Të shkojmë në një udhëtim

Kohëzgjatja: 10 minuta.

Objektiva: Të kuptohet rëndësia e dakordimit për rregullat për barazi dhe siguri të të gjithë pjesëmarrësve.

Zhvillimi:

Lehtësuesi fton pjesëmarrësit që të imagjinojnë se të gjithë po përgatiten për një udhëtim. Sipas preferencave të tij/saj, ai/ajo thotë diçka si: Do të shkonim me furgon, por jemi shumë dhe jo të gjithë mund të marrin çfarë të duan, sepse nuk kemi hapësirë, por unë (ose NE si lehtësues) do të vendos që çfarë mund të marrë secili prej jush (theksoni se lehtësuesit do të përcaktojnë rregullat). Kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që tani të përcaktohet se kush merr çfarë. Nëse e dini "çelësin" me të cilin përcaktojmë se kush mund të merr çfarë, mos e thoni me zë të lartë, por thjesht vazhdoni tutje në të njëjtën mënyrë - kjo do t'ju ndihmojë të tjerët të kuptojnë rregullin me të cilin ata mund të përcaktojnë se çfarë mund të marrin. Përsëriteni emrin tuaj dhe përmendi diçka që do të merrnit, p.sh. Unë jam Gabi dhe do ta sjell një kitarë. Lehtësuesi(t) mund t'ju japë sugjerime pjesëmarrësve sipas emrit, p.sh. për të përsëritur ju jeni Antonio, kështu që ju sugjeroj të sillni një mollë.

Pas aktivitetit: Si u ndjetë derisa e kuptuat rregullin? Si u ndjetë ndërsa ne si lehtësues po vendosnim se kujt i lejohej të merrte çfarë? Për të bashkëpunuar më mirë gjatë këtij programi, është e rëndësishme që për rregullat e punës të pajtohemi BASHKË, në mënyrë që të gjithë të jemi sa më rahat.

2.b Aktiviteti kryesor: Ritual i shkopit që flet

Kohëzgjatja: 30 minuta

Objektiva(t): inkurajimi i dialogut të bazuar në respekt, për të krijuar rregullat bazë për diskutimet në grup

Zhvillimi:

Kërkoni prej pjesëmarrësve që të ulen në një rreth. Duke mbajtur një shkop që flet para jush, tregojuni një histori dhe shpjegoni rregullat e shkopit që flet. Qëllimi i shkopit që flet është të promovojë mirëkuptimin dhe dialogun në mënyrë që pushteti të shpërndahet tek të gjithë. Secili anëtar i grupit ka të drejtë ta kërkojë një shkop, por duhet të tregojë respekt ndaj personit që mban shkopin, duke pritur që ai/ajo të përfundojë. Ngjashëm, secili person

që mban një shkop duhet të jetë i gatshëm t'ia lë dikujt tjetër. Duke e pasuar shkopin në rreth, kërkoni prej secilit pjesëmarrës që shkurtimisht të shprehë një gjë për të cilën ai/ajo shpreson dhe një gjë së cilës i frikësohet në lidhje me punëtorinë. Ata duhet të inkurajohen të fillojnë me "Shpresoj ..." dhe më pas "Kam frikë se...". Secili duhet të kenë një shans për të mbajtur shkopin që flet në duar. Kur shkopi të jetë përsëri në duart tuaja, kërkoni prej pjesëmarrësve që të marrin parasysh rregulla të tjera për bashkëjetesën paqësore ose funksionimin e grupit. Pjesëmarrësit që duan të flasin duhet t'ju drejtohen për shkop, dhe çdo pjesëmarrës pasues që dëshiron të flasë duhet t'i drejtohet personit që mban shkopin në atë moment, e kështu me radhë. Si lehtësues grupi, shkopi nuk duhet t'ju kthehet çdo herë. Duhet të pasohet direkt tek anëtarët e grupit, duke u mundësuar që ta kontrollojnë diskutimin vetë. Kur ju, si lehtësues grupi, dëshironi të flisni, kërkoni shkopin nga personi që po e mban. Shkruani rregullat e sugjeruara nga pjesëmarrësit në një fletë pune/tabelë letre dhe pyesni nëse këto rregulla janë të qarta për të gjithë dhe nëse të gjithë pajtohen me to. Inkurajoni pjesëmarrësit që t'u përmbahen këtyre rregullave dhe rikujtojani njëri-tjetrit ato rregullisht gjatë punëtorisë. Pyesni pjesëmarrësit nëse u pëlqente ta përdornin shkopin që flet dhe nëse do të dëshironin të vazhdonin ta përdornin atë. Në disa grupe, aktiviteti i përdorimit të një shkopi që flet mund të duket aktivitet i rreptë dhe kështu mund ta përdorni vetëm në këtë aktivitet. Në grupe të tjera, mund të përdoret vazhdimisht gjatë gjithë aktivitetëve, ose herë pas here.

○ 3. Aktiviteti: Shpërndarja e pyetësorit të parë

Kohëzgjatja: 10 minuta.

Objektiva: Të mblidhen të dhëna për qëndrimet fillestare të pjesëmarrësve.

Kërkoni prej pjesëmarrësve që të plotësojnë pyetësin, ju shpjegoni pjesëmarrësve se pyetësi është që ne të shohim efektin e punëtorive tona. Shpjegoni se regjistri është anonim dhe se krijimi i një kodi fillestar shërben për të ruajtur anonimitetin e tyre, por në mënyrë që përgjigjet e pyetësorit përfundimtar të mund të lidhen me përgjigjet e pyetësorit të parë. Për të rinjtë që kanë vështirësi në leximin dhe kuptimin e asaj që shkruhet, këshillohet që pyetjet të lexohen me zë të lartë, dhe të sigurohet konfidencialiteti si dhe një hapësirë e sigurt që ata t'i plotësojnë përgjigjet vetë.

○ **Përfundimi i punëtorisë:**

Pasi pjesëmarrësit të kenë vendosur për rregullat e përbashkëta dhe të kuptojnë rëndësinë e rregullave, ftoni që t'i përdornin ato rregulla edhe në jetën e tyre të përditshme, jo vetëm në takimet tuaja.

Punëtorja nr. 2

Kutitë gjinore

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › të kuptohet dallimit midis seksit dhe gjinisë,
 - › të mendohet në mënyrë kritike për rolet gjinore dhe socializimin e burrave dhe grave,
 - › të identifikohen faktorët që ndikojnë në rolet gjinore
- **Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:**
Two flip chart papers, adhesive tape, colored markers

AKTIVITETET

○ 1. Aktiviteti fillestar: Më tregoni pa fjalë

Kohëzgjatja: 5 min

Objektivat: ndarja në 2 grupe, nxitja e komunikimit joverbal

Zhvillimi:

Kërkoni prej pjesëmarrësve që të rreshtohen në formë diagonale, nga më i shkurti tek më i gjati, pa përdorur fjalë. Pas kësaj, jepni disa udhëzime të tjera, të cilat kanë gjithnjë e më pak karakteristika që janë të dukshme. Për shembull, pjesëmarrësve u kërkohet të radhiten sipas ngjyrës së syve, në mënyrë të tillë që në fillim të rreshtit të jetë personi me sytë me ngjyrë të hapur, dhe në fund me ngjyrë më të errët, pastaj sipas ngjyrës së flokëve, përsëri nga më e hapura tek më e errëta, dhe pastaj sipas muajit që kanë lindur.

Pasi të jenë rreshtuar në atë mënyrë, pyesni pjesëmarrësit se si ishte për ta kjo detyra pa folur, që ishte e vështirë. Pastaj grupi të ndahet në dy grupe me të njëjtin numër anëtarësh. Kërkoni prej pjesëmarrësve që në të majtë të qëndrojnë ata që pëlqejnë picat më shumë se akulloret, dhe ata në të djathtë ata që pëlqejnë akulloret më shumë se picat. Ju mund të përdorni terma të tjerë për ta ndarë grupin në mënyrë të barabartë në dy grupe (verë - dimër; mal - det; natë - ditë; mëngjes - mbrëmje). Kur termat arrijnë të ndajnë anëtarët në dy grupe me të njëjtin numër anëtarësh, aktiviteti përfundon, dhe atyre u njoftohet se në aktivitetin e radhës do të ndahen në këto dy grupe. Kërkoni prej grupit të parë që të qëndrojnë në rresht, njëri pas tjetrit. Gjithashtu kërkoni prej grupit të dytë të qëndrojnë në rreshtin e dytë njëri pas tjetrit.

○ 2. Aktiviteti qendror: Çfarë është gjinia?

Kohëzgjatja: 40 min

Kohëzgjatja: 40 minuta

Objektiva (t): të kuptojmë dallimin ndërmjet seksit dhe gjinisë, të mendojmë në mënyrë kritike për rolet gjinore dhe socializimin e burrave dhe grave, të identifikojmë faktorët që ndikojnë në rolet gjinore.

Zhvillimi:

Hiqni të gjitha karriget dhe tavolinat për të liruar hapësirën para dhe pas, për të dyja grupet. Ngjisni një letër flipchart në murin e përpamë dhe shkruani "Grua" sipër letrës dhe vizatoni një rreth të madh në mes të letrës poshtë. Pranë këtij flipchart-i, ngjisni tjetrin që thotë "Burrë" dhe vizatoni një katror të madh poshtë. Sugjeroheni që të përdorni marker rozë ose të kuq për të shkruar fjalën "burrë", dhe marker të zi ose blu për të shkruar fjalën "grua". Rreth 1-2 metra nga muri në dysheme, ngjitni shiritin që do ta shënojë fillimin. Ftojuni grupin 1 të rreshtohet përpara tabelës me fjalën "grua" dhe grupin 2 të rreshtohet përpara tabelës me fjalën "burrë". Përpara fillimit të lojës, nënvizoni para pjesëmarrësve që të kujdesen për veten, të tjerët dhe hapësirën, në mënyrë që të mos dëmtojnë veten apo të tjerët dhe të mos dëmtojnë hapësirën. Tregoni se nëse dikush nuk dëshiron të marrë pjesë, kjo është në rregull, por ftoni që të japin komentet ose mendimet e tyre. Kërkoni prej pjesëmarrësve që të shkruajnë terma që lidhen me fjalën "burrë" ose "grua" brenda rrethit ose katrorit. Lini 90 sekonda kohë në dispozicion. Tregojuni pjesëmarrësve se kanë 90 sekonda për të shkruar fjalën në mënyrë alternative në një copë letër, më pas jepni një laps personit prapa tyre dhe shkoni deri në fund të rreshtit. Informoni pjesëmarrësit se asnjë fjalë nuk është e ndaluar. Ata vetëm duhet të shkruajnë gjënë e parë që ju vjen në mendje. Skuadra me fjalët më të ndryshme (d.m.th. jo dublikate) fiton. Nëse gjatë lojës vëreni se pjesëmarrësit fokusohen më shumë vetëm në një aspekt të jetës së një gruaje apo burri, ndihmoni gjatë lojës duke i udhëzuar që të shkruajnë diçka që lidhet me pamjen, veshjen, sjelljen, profesionin etj.

Pas garës, kaloni disa minuta për të rishikuar listën e pjesëmarrësve. Kaloni nëpër disa fjalë dhe shtroni pyetjet e mëposhtme:

- › Çfarë vëreni kur shikoni fjalët në listën e burrave? A ka fjalë që vlejné vetëm për burrat?
- › Çfarë vini re kur shikoni fjalët në listën e grave? A ka fjalë që vlejné vetëm për gratë?
- › Cili është ndryshimi midis listave për burra dhe listave për gra? Pse disa fjalë janë në njërin anë dhe jo në anën tjetër?
- › A ka burra që përputhen me të gjitha fjalët (karakteristikat dhe cilësitë) që janë shkruar në flipchart për burra? A ka gra që përputhen me të gjitha fjalët në flipchart të grave?
- › Çfarë çon në ndarje të tilla?
- › A mendoni se burrat dhe gratë janë rritur në të njëjtën mënyrë? Çfarë mesazhesh dëgjojnë djemtë kur rriten dhe çfarë mesazhe dëgjojnë vajzat kur rriten?

Së pari, rrethoni fjalët që i referohen seksit biologjik dhe nënvizoni se këto fjalë kanë lidhje me seksin e personit. Sqaroni për pjesëmarrësit se ka njerëz që janë interseks dhe të cilët në lindje nuk janë padyshim burra apo gra, dhe se ka njerëz (persona transgjitorë) gjinia e të cilëve ndryshon nga gjinia që u atribuohet në lindje. Më pas rrethoni fjalët që theksohen – shikoni përshkrimet si "i guximshëm" ose "i kujdesshëm". Theksoni se këto stereotipe mund të jenë të dëmshme për individin si dhe për shoqërinë në tërësi. Kjo na vendos në një kornizë të kufizuar që mund të çojë në probleme më të mëdha (mungesë emocionale, probleme të shëndetit mendor, përjashtim).

Shtrojini atyre pyetjen: Çfarë ndodh nëse një burrë nuk është diçka që përmendet në listë? Për shembull, nëse një burrë nuk është i guximshëm, si quhet ai? Shkruani sharjet dhe sjelljet (fjalët) me ngjyrë tjetër jashtë kutisë.

Bëni të njëjtën gjë me rrethin: Çfarë ndodh nëse një grua nuk paraqet ato që janë shkruar në listë? Shkruajini sharjet dhe sjelljet me ngjyrë tjetër.

Diskutoni me pjesëmarrësit se çfarë dallohet në sharje. Sharjet në flipchart-in e burrave vlejné për gratë dhe e kundërta.

○ Përfundimi i punëtorisë:

Gjatë gjithë jetës sonë, ne marrim mesazhe nga familjet, media dhe shoqëria jonë se si duhet të sillemi si burra dhe si duhet t'i trajtojmë gratë dhe burrat e tjerë. Është e rëndësishme të kuptojmë se, edhe pse ka dallime midis burrave dhe grave, shumë prej këtyre dallimeve janë krijuar vetëm nga shoqëria dhe nuk janë pjesë përbërëse e natyrës ose kompleksit tonë biologjik. Megjithatë, këto dallime kanë një ndikim të rëndësishëm në jetën e përditshme të burrave dhe grave dhe në marrëdhëniet midis tyre. Për shembull, një burrë shpesh pritet të jetë gjithmonë i fortë dhe dominues në marrëdhëniet e tij me të tjerët, përfshirë marrëdhëniet me partnerët e tij intim. Në të njëjtën kohë, një grua shpesh pritet t'i nënshtrohet autoritetit të një burri. Dhe kur burrat dhe gratë nuk përshtaten në kuadrin që u është dhënë, ata shpesh bien viktima të dhunës (shikoni sharjet dhe sjelljet e tjera jashtë kornizës). Shumë prej këtyre stereotipeve të ngurta gjinore kanë pasoja si për burrat ashtu edhe për gratë, të cilat do t'i diskutojmë gjatë këtyre aktiviteteve. Derisa të vetëdijësoheni më shumë për mënyrën se si stereotipe të caktuara gjinore mund të ndikojnë negativisht si tek burrat ashtu edhe tek gratë, mund të mendoni në mënyrë konstruktive se si t'i sfidoni ato dhe të promovoni rolin pozitiv të gjinisë.



Punëtorja nr. 3

Kujdesi për veten

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › Rritja e vetëdijesimit për mënyrën se si rriten burrat dhe se me cilat rreziqe shëndetësore ballafaqohen
- **Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:**
2 letra A4 dhe markerë, fletët e punës A dhe B

AKTIVITETET

○ 1. Aktiviteti fillestar: Pasqyra

Kohëzgjatja: 5 minuta

Objektiva e aktivitetit fillestar: Ushtrimi i përqendrimit dhe sinkronizimi i lëvizjeve

Zhvillimi:

Ky ushtrim realizohet në çifte. Në fillim personat qëndrojnë njëri pas tjetrit. Njërit person në çift i jepet detyra të bëjë lëvizje të ndryshme të krahëve dhe këmbëve, ndërsa personi tjetër duhet t'i pasqyrojë ato lëvizje. Pas një kohe rolet ndryshojnë.

○ 2. Aktiviteti qendror: Kujdesi për veten: burrat, aspekti gjinor dhe shëndeti

Kohëzgjatja: 50 minuta

Objektiva e aktivitetit qendror: Të rrisë nivelin e ndërgjegjësimit për mënyrën se si rriten djemtë dhe rreziqet shëndetësore me të cilat përballen

Zhvillimi:

Para realizimit përgatitni hapësirën për aktivitetin. Zhvendosni të gjitha karriget dhe tavolinat në skajin e dhomës, ngjitni letrën A4 me fjalën gratë në një mur dhe ngjitni letrën A4 me fjalën burrë të shkruar në murin përballë. Shpjegojini grupit se do të lexoni një sërë pyetjesh dhe për secilën pyetje do të ketë tre përgjigje të mundshme: burra, gra ose të dyja, ose nuk e di. Kërkoni prej grupit të pozicionohen brenda dhomës, pasi të kenë lexuar secilën pyetje, sipas përgjigjes që ata mendojnë se është e saktë. Nëse mendojnë se përgjigja e saktë është gratë, ata shkojnë në anën ku është ngjitur letra me fjalën gratë. Nëse mendojnë se përgjigja e saktë janë burrat, ata do të qëndrojnë në anën ku është ngjitur letra me fjalën burrat. Nëse mendojnë se përgjigja është edhe gratë edhe burrat, ose nëse nuk e dinë përgjigjen, ata do

të qëndrojnë në mes. Pasi të lexohet çdo pyetje, kur të gjithë të jenë pozicionuar brenda dhomës, pyetni të paktën një person nga secili grup për mendimin e tyre se përse po qëndronin tek përgjigja e caktuar, ose pse mendojnë se përgjigja është ajo. Pasi të keni lexuar të gjitha pyetjet dhe komentuar përgjigjet, shpjegoni atyre se përgjigja e saktë për secilën pyetje janë burrat. Shqyrtoni secilën pyetje individualisht dhe paraqisni statistikat e renditura në materialin shtesë. Përdorni pyetjet e mëposhtme për të diskutuar:

- › Si ndodh që burrat vdesin më shpesh në aksidente automobilistike?
- › Pse mendoni se burrat kujdesen më pak për shëndetin e tyre?
- › A i shihni modelet e mësipërme të sjelljes së rrezikshme tek burrat në mjedisin tuaj?
- › Cila është lidhja midis këtyre rreziqeve dhe mënyrës se si të djemtë socializohen? (Mund t'ua rikujtoni diskutimin e mëparshëm dhe mesazhet që vajzat dhe djemtë dëgjojnë ndërsa rriten)
- › Çfarë mund të bëni për të reduktuar rreziqet në jetën tuaj?

○ Përfundimi i punëtorisë:

Shumica e shkaqeve të vdekjes tek burrat lidhen me stilin e jetës vetë-shkatërruese që shumë burra jetojnë. Në të gjithë botën, burrave u bëhet presion për t'u sjellë në modele të caktuara. Për shembull, burrat kanë më shumë gjasa të ndërmarrin rreziqe, të kenë më shumë partnerë, të jenë më agresivë ose të prirur ndaj dhunës në marrëdhëniet e tyre me të tjerët - gjë që i vë ata dhe partnerët e tyre në rrezik. Është e rëndësishme që djemtë e rinj të jenë kritikë ndaj stilit të tyre të jetesës dhe mënyrave se si ata rrezikojnë. Ju mund të jeni rritur që të keni besim, të mos shqetësoheni për shëndetin tuaj dhe/ose të mos kërkonin ndihmë kur jeni nën stres. Por aftësia për të folur hapur për problemet tuaja dhe për të kërkuar mbështetje janë mënyra të rëndësishme për të mbrojtur veten nga shumë rezultate shëndetësore negative - si përdorimi i narkotikëve, sjellja seksuale e rrezikshme dhe prirja për dhunë. Nëpërmjet të menduarit kritik për këto norma, mund të mësoni se shëndeti nuk është vetëm një çështje për të cilën kujdesen gratë, por për të cilën duhet të kujdesen edhe burrat dhe të mësojnë se si të kujdesen më mirë për veten.



FLETË PUNE A – Pyetjet:

1. Kush ka jetën më të shkurtër?

2. Kush ka më shumë gjasa të vdesë si viktimë e vrasjes?

3. Kush ka më shumë gjasa të vdesë në një aksident automobilistik?

4. Kush ka më shumë gjasa të kryejë vetëvrasje?

5. Kush ka më shumë gjasa të konsumojë alkoolin dhe të dehet?

6. Kush ka më shumë gjasa të vdesë për shkak të mbidozës (mbipërdorimi i narkotikëve)?

7. Kush ka më pak gjasa të kërkojë ndihmë mjekësore?

FLETË PUNE B - Përgjigjet:

1. Kush ka jetën më të shkurtër?

Burrat në përgjithësi jetojnë më pak, dhe në Ballkanin Perëndimor jetëgjatësia ndryshon midis 73.5 – 76.3 për burrat, ndërsa midis 78.3 – 81.6 vjet për gratë.

(Organizata Botërore e Shëndetësisë. Jetëgjatësia dhe Jetëgjatësia e Shëndetshme – Të dhënat sipas vendeve 2020.)

2. Kush ka më shumë gjasa të vdesë si viktimë e vrasjes?

Sipas Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Droga dhe Krim, 78.7% e viktimave të vrasjeve në mbarë botën janë burra, dhe në 193 nga 202 vendet ose rajonet e listuara, burrat kanë më shumë gjasa të vriten sesa gratë. Statistikat e krimit tregojnë se burrat kanë më shumë gjasa të jenë autorë krimesh, por edhe viktimë të dhunës ndërpersonale.

(Kombet e Bashkuara. Zyra për Droga dhe Krim – të dhënat sipas vendeve 2018, <https://dataunodc.un.org/>)

3. Kush ka më shumë gjasa të vdesë në një aksident automobilistik?

Që në moshë të re, burrat kanë më shumë gjasa të përfshihen në aksidente në trafikun rrugor sesa gratë. Rreth tre të katërtat (73%) e të gjitha vdekjeve në trafikun rrugor ndodhin tek djemtë nën moshën 25 vjeç, të cilët kanë pothuajse 3 herë më shumë gjasa të vriten në një aksident rrugor sesa vajzat.

(Kombet e Bashkuara. Organizata Botërore e Shëndetësisë <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/road-traffic-injuries>)

4. Kush ka më shumë gjasa të kryejë vetëvrasje?

Më shumë se 700,000 njerëz vdesin nga vetëvrasjet çdo vit. Për më tepër, për çdo vetëvrasje, ka më shumë se 20 tentativa për vetëvrasje. Në botë, dy të tretat e vdekjeve nga vetëvrasja janë burra.

(GBD 2015 "Mortality and Causes of Death, Collaborators". (8 tetor 2016). "Jetëgjatësia globale, rajonale dhe kombëtare, vdekshmëria nga të gjitha shkaqet dhe vdekshmëria specifike për 249 shkaqe vdekjesh, 1980-2015: një analizë sistematike për Studimin e Barrës Globale të Sëmundjeve 2015")

(Kombet e Bashkuara. Organizata Botërore e Shëndetësisë https://www.who.int/health-topics/suicide#tab=tab_1)

5. Kush ka më shumë gjasa të konsumojë alkool dhe të dehet?

Konsumimi i alkoolit ka qenë prej kohësh një aktivitet i dominuar nga burrat. Globalisht, burrat konsumojnë më shumë alkool dhe shkaktojnë më shumë dëme të lidhura me alkoolin për veten dhe të tjerët sesa gratë. Në vitin 2016, 54% e meshkujve (1.46 miliardë) dhe 32% e femrave (0.88 miliardë) të moshës 15 vjeç e sipër në botë kanë konsumuar alkool.

(White, AM (2020). Dallimet gjinore në epidemiologjinë e përdorimit të alkoolit dhe dëmet e lidhura me të në Shtetet e Bashkuara. Hulumtimi i alkoolit: rishikimet aktuale, 40 (2).)

(https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Alcohol_consumption_statistics)

6. Kush ka më shumë gjasa të vdesë për shkak të mbidozës (përdorimi i tepruar i narkotikëve)?

Në mbarë botën, midis moshës 15 dhe 29 vjeç, vdekjet nga përdorimi i tepruar i alkoolit të meshkujt janë më të mundshme. Numri i përgjithshëm i personave në trajtim për abuzim me drogën në vitin 2020 ishte 736, prej të cilëve 81% ishin meshkuj.

(Raporti i Statusit Global të OBSH-së mbi Alkoolin, 2004)

(Vjetari Shëndetësor dhe Statistikor i Qytetit të Zagrebit për vitin 2020)

7. Kush ka më pak gjasa të kërkojë ndihmë mjekësore?

Në mbarë botën, burrat kanë më pak gjasa të kërkojnë ndihmë mjekësore sesa gratë.

(Addis, M.E., & Mahalik, J.R. (2003). Burrat, maskiliteti dhe kontekstet e kërkimit të ndihmës. Psikolog amerikan, 58(1), 5.)

Punëtorja nr. 4

Si i shpreh ndjenjat e mia?

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › Inkurajoni pjesëmarrësit që të mendojnë për ndjenjat e tyre dhe t'i shprehin ato
 - › Njihni vështirësitë që hasin të rinjtë në shprehjen e ndjenjave të caktuara
 - › Njihni pasojat e mosshprehjes së ndjenjave
- **Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:**
Letër flipchart, markerë, copa letre dhe materiale shtesë

AKTIVITETET

○ 1. Aktiviteti fillestar: Si ndjehem?

Kohëzgjatja: 15 minuta

Objektiva(t): Të inkurajojë të menduarit për ndjenjat dhe të diskutojë mënyrën se si pjesëmarrësit i shprehin dhe i përjetojnë ato.

Zhvillimi:

Pjesëmarrësit ulen në rreth. Secili person me radhë shfaq emocione të caktuara. Pjesëmarrësit e tjerë përpiqen të marrin me mend se çfarë ndjenje po përshkruan personi në mënyrë specifike. Personi që e gjen, e përshkruan emocionin e radhës. Kushtoni vëmendje njohjes dhe emërimit të emocioneve të ndryshme. Nëse ka përsëritje të emocioneve të caktuara, komentoni se si i njëjti emocion mund të shfaqet ndryshe.

○ 2. Aktiviteti qendror: Shprehja e ndjenjave

Kohëzgjatja: 45 minuta

Objektiva(t): Të njohë vështirësitë me të cilat përballen të rinjtë në shprehjen e ndjenjave të caktuara, pasojat për ta dhe marrëdhëniet e tyre.

Zhvillimi:

Përpara se të fillojë punëtorja, lehtësuesi inkurajohet të analizojë në mënyrë të pavarur këtë aktivitet dhe të mendojë se si ai ose ajo i shpreh ndjenjat e tij/saj. Është po ashtu e rëndë-

sishme të identifikohen qendrat lokale të këshillimit ose ekspertët e kësaj fushe, tek të cilët të rinjtë mund të drejtohen nëse kanë nevojë.

Vizatoni pesë kolona në letrën flipchart dhe shkruani ndjenjat e mëposhtme si tituj: frikë, dashuri, trishtim, lumturi dhe zemërim (shihni fletën e punës si shembull se si duhet të renditen fjalët sipas sqarimit në vijim). Më pas shpjegojuni pjesëmarrësve se ato ndjenja do të diskutohen gjatë atij aktiviteti dhe le të mendojnë se sa e lehtë apo e vështirë është për të rinjtë dhe të rejtat t'i shprehin ato ndjenja. Shpjegojuni pjesëmarrësve se çfarë nënkupton secili emocion.

Jepini secilit pjesëmarrës pesë copa letre dhe le të shkruajnë një numër nga 1 deri në 5 në secilën fletë. Le të mendojnë se cilat prej ndjenjave në flipchart ata i shprehin me lehtësi ose vështirësi dhe le t'i rendisin ose t'i vendosin ato në kolonën e duhur në flipchart. Për shembull, "Vendosni numrin një (1) pranë ndjenjës që ju duket më e lehtë dhe vendosni numrin pesë (5) pranë ndjenjës që ju duket më e vështirë për t'u shprehur."

Kur pjesëmarrësit ta kenë përfunduar renditjen e ndjenjave të tyre, numëroni të gjitha notat në secilën kolonë dhe shkruani totalin në fund të secilës kolonë (shihni shembullin). Në përfundim - si grup, më e lehtë për t'u shprehur është ndjenja me shumën më të vogël, dhe më e vështira është ndjenja me shumën më të madhe.

KOMENTE: Nëse jeni duke punuar me një grup të përzier të rinjsh dhe të rejsh, përgatitni dy fletë flipchart me pesë kolona ndjenjash, të shkruara në secilën letër, dhe djemtë t'i rendisin ndjenjat e tyre në njërin, dhe vajzat në tjetrën. Mblidhni pikët në secilën kolonë dhe krahasoni dallimet me pjesëmarrësit. Për të nisur diskutimin, përdorni pyetjet e mëposhtme:

- › A keni zbuluar diçka të re për veten tuaj nga ky aktivitet?
- › Pse disa njerëz e kanë më të lehtë të shfaqin disa ndjenja dhe të shtypin të tjerat? Cilat janë pasojat e shtypjes së ndjenjave?
- › A ka ngjashmëri në mënyrën se si burrat i shprehin ndjenjat e caktuara? A ka ngjashmëri në mënyrën se si gratë i shprehin ndjenjat e caktuara?
- › A ka dallime në mënyrën se si burrat dhe gratë i shprehin ndjenjat e tyre? Cilat janë dallimet?
- › A i shprehin gratë disa ndjenja më lehtë se burrat? Pse ndodh kjo?
- › Pse burrat dhe gratë i shprehin ndjenjat e tyre në mënyra të ndryshme? Si ndikojnë bashkëmoshatarët, familja, komuniteti, media, etj., në mënyrën se si burrat dhe gratë i shprehin ndjenjat?
- › Si ndikon mënyra se si i shprehim ndjenjat tona në marrëdhëniet tona me njerëzit e tjerë (partnerët, familjen, miqtë, etj.)?
- › A është më e lehtë apo më e vështirë për të shprehur ndjenja ndaj bashkëmoshatarëve? Familjes? Partnerëve intimë?
- › Pse janë të rëndësishme ndjenjat? Jepni shembuj, nëse është e nevojshme: Frika na ndihmon në situata të rrezikshme; zemërimi na ndihmon të mbrohemi. Gjithashtu, kërkoni prej pjesëmarrësve që të japin disa shembuj.
- › Çfarë mendoni, në çfarë mënyre shprehja më e hapur e ndjenjave tuaja mund të ndikojë në mirëqenien tuaj ose në marrëdhëniet tuaja me njerëzit e tjerë (partnerët romantikë, familjen, miqtë, etj.)?
- › Çfarë mund të bëni për t'i shprehur më hapur ndjenjat tuaja? Si mund të jeni më fleksibil në shprehjen e asaj që ndjeni?

○ Përfundimi i punëtorisë:

Emocionet mund të shihen si një formë energjie që ju lejon të perceptoni atë që ju shtyp ose ju shqetëson. Emocionet e ndryshme janë thjesht një pasqyrim i nevojave të ndryshme dhe është më mirë të mësoni se si t'i trajtoni të gjitha emocionet tuaja ashtu siç shfaqen në jetën tuaj. Të jesh në gjendje të shprehësh emocionet e tua pa i shkaktuar dëm të tjerëve ju ndihmon të bëheni më të fortë si individë dhe ju ndihmon të lidheni më mirë me botën përreth jush. Mënyra se si i shpreh emocionet çdo person ndryshon. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohen një sërë tendencash që shfaqen, veçanërisht lidhur me mënyrën se si rriten djemtë. Për shembull, është e zakonshme që të rinjtë të shoqërohen për të fshehur frikën, trishtimin dhe madje mirësinë. Por është gjithashtu e zakonshme që ata të shprehin zemërimin e tyre nëpërmjet dhunës. Edhe pse ju nuk jeni përgjegjës për të ndjerë emocione të caktuara, ju jeni përgjegjës për atë që bëni me atë që ndjeni. Është e rëndësishme të bëhet dallimi midis "ndjenjës" dhe "të vepruarit" në mënyrë që të gjejmë forma të shprehjes që nuk sjellin dëm për veten apo për të tjerët.

FLETA E PUNËS: Model i radhitjes së ndjenjave në letrën e flipchart

Fleta e punës në vijim është një shembull i mënyrës së si të organizojmë ndjenjat dhe përgjigjet e pjesëmarrësve. Gjatë punëtorisë, lehtësuesi duhet të ndihmojë pjesëmarrësit për të identifikuar ngjashmëritë dhe dallimet në renditje. Për shembull, tabela e sipërpërmendur tregon se ka një ndarje pothuajse të barabartë në numrin e pjesëmarrësve që e kanë të lehtë të shprehin zemërimin dhe atyre që e kanë të vështirë. Kjo mund të çojë në dialog për këtë çështje se përse ekzistojnë këto dallime dhe nëse të rinjtë e kanë apo jo të lehtë/të vështirë të shprehin zemërimin. Një model tjetër interesant në shembullin e mëposhtëm është se si shumica e pjesëmarrësve e kanë të vështirë të shprehin frikën. Prej burrave shpesh pritet vërtet të jenë të guximshëm dhe të patrembur, dhe do të ishte interesante që ky shembull të përdoret si bazë për dialogun mbi socializimin dhe normat gjinore. Përfundimisht, është e rëndësishme të mbani mend se grumbullimi i pikëve dhe futja e renditjes në tabelë duhet të jetë anonime.

FRIKË	DASHURI	TRISHTIM	LUMTURI	ZEMËRIM
(shkruani shumën totale të notave në fund)	(shkruani shumën totale të notave në fund)	(shkruani shumën totale të notave në fund)	(shkruani shumën totale të notave në fund)	(shkruani shumën totale të notave në fund)

Punëtorja nr. 5

Jam i zemëruar dhe çfarë të bëj?

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › Njohja e ndjenjave të zemërimit
 - › Shprehja e zemërimit në mënyrë konstruktive dhe jo të dhunshme
- **Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:**

2 shalle me ngjyra të ndryshme, letër flipchart, stilolapsa, shirit ngjites dhe një numër i mjaftueshëm kopjesh të fletëve të punës për secilin pjesëmarrës.

AKTIVITETET

○ 1. Aktiviteti fillestar: Bishti i dragoit

Kohëzgjatja: 15 minuta

Objektiva(t): Krijimi i energjisë në grup dhe zhvillimi i kohezionit në grup
Zhvillimi:

Ndani grupin në dy grupe të vogla. Secili grup përfaqëson një dragua në një mënyrë që secili person e mban një person tjetër për beli në të njëjtin rresht. Personi i fundit në rresht ka një shall me ngjyra të ndezura të ngjitur në pantallona ose një rrip që përfaqëson bishtin e një dragoi. Qëllimi është të kapni bishtin e një dragoi tjetër pa humbur bishtin tuaj.

○ 2. Aktiviteti qendror: Çfarë bëj kur zemërohem?

Kohëzgjatja: 45 minuta

Objektiva(t): Njihni ndjenjat e zemërimit dhe shprehni zemërimin në mënyrë konstruktive dhe jo të dhunshme

Zhvillimi:

Shpjegojini grupit se qëllimi i këtij aktiviteti është të flasim për mënyrën se si të rinjtë e shprehin zemërimin, ndaj shpërndani kopjet e fletëve të punës tek të gjithë pjesëmarrësit. Lexoni secilën pyetje dhe kërkonit prej pjesëmarrësve që t'u përgjigjen pyetjeve individualisht. Jepuni atyre dy ose tre minuta kohë. Për grupet që nuk dinë shkrim-lexim, kapaciteti është i kufizuar. Lexoni pyetjet me zë të lartë dhe pjesëmarrësit të bisedojnë në çift ose të bëjnë foto. Pasi të keni plotësuar fletët e punës, ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla me nga katër ose pesë. Lërin të ndajnë përgjigjet e tyre me njëri-tjetrin. Jepuni atyre 20 minuta kohë për këtë punë në grup.

Derisa pjesëmarrësit janë ende në grupe të vogla, shpërndani letrën tek secili grup dhe kërkojuni që t'i krijojnë dy lista: "Mënyra negative për të reaguar kur jemi të zemëruar" dhe "Mënyra pozitive për të reaguar kur jemi të zemëruar". Jepuni grupeve 15 minuta kohë për të krijuar listën. Më pas kërkonit prej secilit grup që t'i paraqesë përgjigjet e tyre para të tjerëve. Pastaj filloni diskutimin mbi pyetjet e mëposhtme:

- › Në përgjithësi, a është e vështirë për burrat që të shprehin zemërimin pa ushtruar dhunë? Pse?
- › Po vajzat e reja? A e shprehin zemërimin po aq lehtë?
- › Cilat janë modelet tona për të mësuar, si t'i shprehim emocionet tona, përfshirë zemërimin?
- › Shpesh dimë të shmangim konfliktin apo grindjen, pa përdorur dhunë, por nuk e bëjmë këtë. Pse?
- › Çfarë do të ndodhte nëse nuk do ta shprehnim zemërimin atëherë kur e ndjejmë?
- › A është e mundur që të "përbaheni dhe të bëjmë një pushim, për të zvogëluar numrin e konflikteve? A keni përvojë në përdorimin e kësaj strategjie? Si funksionoi?
- › A keni provuar të numëroni në heshtje deri në 10 për të ndihmuar në kontrollimin e zemërimit tuaj?
- › A është e mundur të "përdoren fjalë pa fyer"?
- › A ka mënyra të tjera se si mund ta përballojmë zemërimin në mënyrë më konstruktive?
- › Çfarë mësuar nga ky aktivitet? Si mund ta aplikoni këtë në jetën tuaj dhe në marrëdhëniet tuaja?

○ Përfundimi i punëtorisë:

Zemërimi është emocion normal i çdo qenieje njerëzore në një moment të jetës së tyre. Megjithatë problemi është se disa njerëz mund të ngatërrojnë zemërimin dhe dhunën, duke menduar se janë të njëjta dhe duke menduar se dhuna është një mënyrë e pranueshme për shprehjen e zemërimit. Përmes zemërimit - lehtë mund të ndodhë që ne të lëndojmë dikë dhe më vonë të kuptojmë se nuk ka pasur arsye për këtë. Zakonisht është më e lehtë të arrini atë që doni nëse e mbani nën kontroll zemërimin tuaj. Të kontrollosh zemërimin nuk do të thotë të mbulosh zemërimin. Të kontrollosh zemërimin do të thotë ta shprehësh atë në një mënyrë të pranueshme që nuk do të lëndojë askënd. Ajo që kemi përmendur sot mund t'ju ndihmojë, si frymëmarrja e thellë, numërimi deri në 10 dhe më pas të flisni për ato që ju zemërojnë.

FLETA E PUNËS: Një tabelë për të menduar se çfarë bëj kur zemërohem?

- › Mendoni për një situatë që ju ka ndodhur kohët e fundit kur keni qenë të zemëruar. Çfarë ka ndodhur? Përshkruani shkurtimisht situatën (një ose dy fjali).
- › Tani, duke menduar për atë situatë, përpiquini të mbani mend atë që keni menduar dhe ndërjet. Mundohuni të renditni një ose dy ndjenjat që keni ndërjet.
- › Shumë shpesh, kur ndiejmë zemërim, reagojmë me dhunë. Kjo mund të ndodhë edhe para se të kuptojmë se jemi të zemëruar. Disa njerëz reagojnë menjëherë, duke bërtitur, duke hedhur gjëra në dysheme, duke goditur diçka apo dikë. Ndonjëherë ne mund të biem edhe në depresion, të jemi të qetë dhe introspektivë. Duke kujtuar një situatë kur ishit të zemëruar, si e shprehët zemërimin? Si jeni sjellë? (Shkruani një fjali ose disa fjali për mënyrën se si keni reaguar, çfarë keni bërë dhe si jeni sjellë).

Punëtorja nr. 6

Nderi pa dhunë

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › Analizoni në mënyrë kritike nocionin e nderit,
 - › Kuptoni kur nderi ndeshet me dhunë
 - › Inkurajoni pjesëmarrësit që të kërkojnë sjellje jo të dhunshme
- **Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:**

Muzikë (celular ose laptop për të luajtur një melodi), letra dhe stilolapsa, fletën e punës A.

AKTIVITETET

○ 1. Introductory activity: Molecules

Kohëzgjatja: 5 minuta

Objektiva(t): Ushtrimi për të fuqizuar kohezionin e grupit

Zhvillimi:

Filloni një aktivitet në natyrë, vendosni karriget dhe tavolinat në skajet e dhomës. Kërkoni prej pjesëmarrësve që të lëvizin lirshëm. Shpjegoni se pjesëmarrësit duhet të formojnë një grup të vogël me madhësinë e numrit që thoni (d.m.th., molekulat). Thuajeni numrin pesë (5) dhe ndaloni muzikën. Ata që nuk kanë arritur të formohen në molekulë presin për raundin tjetër. Përsëriteni procesin disa herë dhe në fund thuajeni numrin që të gjithë të jenë brenda molekulës.

○ 2. Aktiviteti qendror: Budalla i gjallë ose hero i vdekur

Kohëzgjatja: 50 minuta

Objektiva(t): Për të konsideruar në mënyrë kritike konceptin e "nderit të mashkullit", për të lidhur konceptin e "nderit të mashkullit" me dhunën, dhe për të elaboruar alternativat e dhunës.

Zhvillimi:

Shpjegoni se secili grup duhet të përgatisë dhe paraqesë një shfaqje të shkurtër (3-5 minuta) bazuar në një raport rasti. Caktoni një raport rasti për secilin grup. SHËNIM: Përpara se ta realizoni punëtorinë, caktoni emrat e personazheve, sigurohuni që emrat që përdorni të mos jenë emrat e pjesëmarrësve të grupit. Nëse dëshironi mos ngurroni të shtoni më shumë detaje në raportin e rastit. Gjithashtu, para se ta luani shfaqjen, rikujtoni pjesëmarrësit që të

kujdesen për veten, të tjerët dhe hapësirën, në mënyrë që të mos e lëndojnë as veten e as të tjerët. Nëse mendoni se mund të ketë konflikt fizik midis pjesëmarrësve, jepni udhëzime për ta prezantuar shfaqjen me gojë dhe ta ritregoni si histori. Jepuni grupeve rreth 15 minuta kohë për të diskutuar raportin e rastit dhe për të shkruar një shfaqje të shkurtër. Ftoni grupet që të interpretojnë shfaqjet e tyre para të tjerëve. Pas çdo shfaqjeje, jepuni atyre kohë për të komentuar dhe diskutuar në bazë të pyetjeve të mëposhtme:

- › A janë këto situata reale?
- › Pse ndonjëherë reagojmë në këtë mënyrë?
- › Kur përballeni me një situatë të ngjashme, një situatë kur dikush ju lëndon, si reagoni?
- › Si mund ta ulni tensionin ose agresivitetin në situata si kjo?
- › A mund t'i shpëtojë një zënke një mashkull i vërtetë?
- › Në çfarë mënyrash mund të shmangen konfliktet?
- › Si mund të reagonin ndryshe?

Pyesni pjesëmarrësit nëse kanë dëgjuar për termin "nderi i mashkullit" dhe pyesni se çfarë mendojnë se si u krijua kjo sintagmë. (Kujtojuni atyre normat dhe pritshmëritë gjinore që keni diskutuar tashmë në punëtorinë e mëparshme.)

○ Përfundimi i punëtorisë:

Ideja e "nderit të mashkullit" është ende e fortë në shumë komunitete. Duke lënë përshtypjen e një personaliteti të fortë dhe të rrezikshëm, dikush nuk i ikë përleshjes/grindjes - shumë djem dhe vajza e shohin këtë si mënyrë për të siguruar respekt dhe qëndrim mbrojtës ndaj mjedisit. Megjithatë, siç e përmendëm në këtë aktivitet, ideja e "nderit" shpesh vjen me shumë rreziqe dhe pasoja. Dhe, derisa keni gjasa që të ndiheni të lënduar më shumë se një herë në jetën tuaj, është shumë e rëndësishme të mësoni se si të përballeni me të, me situata si kjo dhe me ndjenjat tuaja ashtu që të mos ju rrezikojnë ju ose të tjerët.



FLETA E PUNËS A:

Raporti i rastit nr. 1

Personi A dhe personi B debatojnë në pushim për detyrat e shkollës. Ata akuzojnë njëri-tjetrin për mashtrim. Personi B thotë se do të presë jashtë personin A për ta sqaruar këtë çështje. Kur mbaron ora...

Raporti i rastit nr. 2

Një grup shokësh janë në një lojë futbolli. Ata janë tifozë të të njëjtit ekip. Përleshja fillon dhe kur vjen një tifoz i ekipit kundërshtar...

Raporti i rastit nr. 3

Një grup shokësh ulen në një kafene. Fillon një përleshje në mes të një të riu dhe një të panjohuri (po ashtu i ri)...

Raporti i rastit nr. 4

Një grup shokësh shkojnë në një kërcim. Njëri prej tyre, X, e sheh një djalë të ri duke i'a ngulur sytë të dashurës së tij. Përleshja fillon kur X...

Raporti i rastit nr. 5

Personi A e ka ndaluar makinën e tij për shkak të bllokimit të trafikut. Kur përpiqet të kthehet djathtas, një makinë tjetër, në të majtë, ia kalon rrugën - kështu që atij i duhet të frenojë fort. Personi A atëherë...

Raporti i rastit nr. 6

Një grup të rinjsh janë ulur në park. Pranë tyre kalon një i ri rom dhe nis një sherr kur...

Raporti i rastit nr. 7

I riu A dhe i riu B janë përfshirë në një debat të ashpër. I riu A ngre zërin dhe ...

Raporti i rastit nr. 8

Një grup të rinjsh nga një qytet i vogël e vizitojnë kryeqytetin. Në bazë të dialektit të tyre, mund të konkludohet lehtësisht se ata vijnë nga një zonë tjetër, gjë që i fut në konflikt me të rinjtë e qytetit, kur ...

Punëtorja nr. 7

Raportet romantike në mes të të rinjve

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › Inkurajoni diskutimin dhe të menduarit për besimin
 - › Identifikoni karakteristikat e një marrëdhënieje të shëndetshme
- **Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:**

Çdo gjë që mund të shërbejë si pengesë fizike (letër, top, karrige, tavolinë, kuti, etj.), letër flipchart, markera, gërshtë, ngjitës dhe kopje të fletës së punës.

AKTIVITETET

○ 1. Aktiviteti fillestar: Shenja drejtuese

Kohëzgjatja: 15 minuta

Objektiva(t): Të inkurajohet të menduarit për besimin në një marrëdhënie
Zhvillimi:

Pjesëmarrësit do të ndahen në çift. Njëri prej pjesëmarrësve vendos një shirit për të mbyllur sytë e tij/saj. Pasi gjysma e pjesëmarrësve t'i kenë mbyllur sytë, rreth dhomës/hapësirës do të vendosen pengesat (letër, top, karrige, tavolinë, kuti, etj.). Partneri i tyre më pas i udhëzon me kujdes përreth zonës, duke u kujdesur që të mos pengohen ose shkelin ndonjë pengesë. Pas një kohe, lehtësuesi u kërkon që çiftet të ndryshojnë rolet dhe kur personi tjetër i çiftit i lidh sytë, lehtësuesi ndryshon vendin e pengesave. Përfundimisht, pjesëmarrësit diskutojnë për mënyrën se si ndihen kur duhet t'i besojnë dikujt tjetër që kujdeset për ta.

○ 2. Aktiviteti qendror: Marrëdhëniet e të rinjve

Kohëzgjatja: 45 minuta

Objektiva(t): Të identifikohen karakteristikat e një marrëdhënieje të shëndetshme.
Zhvillimi:

Meqë mund të ketë mendime të ndryshme mbi atë se çfarë quhet marrëdhënie e shëndetshme ose e pashëndetshme, përpara fillimit të aktivitetit, lehtësuesi duhet të punojë me grupin për të arritur konsensus.

Vizatoni dy kolona në letrën e flipchart. Në njërin shkruani "marrëdhënie të shëndetshme" dhe në tjetrën "marrëdhënie jo të shëndetshme". Ndajini pjesëmarrësit në tre ose katër grupe më të vogla dhe jepini secilit grup një kopje të Materialit Shtesë. Kërkoni prej secilit grup që të presë, radhitë dhe vendosë situatat në marrëdhëniet intime ose nën kolonën "marrëdhënie të shëndetshme" ose nën kolonën "marrëdhënie jo të shëndetshme". Jepuni grupeve 15 minuta kohë për ta përfunduar detyrën. Tregojini grupit që, nëse u premtan koha, ata mund të përdorin fushat e zbrazëta në fund të Materialit Shtesë për të hartuar skenarët e tyre dhe për t'i klasifikuar ata si të shëndetshëm ose të pashëndetshëm. Rishikoni fletën e punës *Situatat në marrëdhëniet intime* dhe kërkoni nga secili grup që të shpjegojë pse ata kishin vendosur situata të caktuara si "të shëndetshme" ose "të pashëndetshme". Për të përmbledhur diskutimin, përdorni pyetjet e mëposhtme:

- › A janë këto situata reale?
- › A e keni gjetur ndonjëherë veten në ndonjë prej këtyre situatave? Si jeni ndjerë?
- › Si reagon komuniteti ndaj situatave të tilla?
- › Cilat janë karakteristikat më të zakonshme të marrëdhënieve të shëndetshme?
- › Cilat janë karakteristikat më të zakonshme të marrëdhënieve jo të shëndetshme?
- › A mendoni se të rinjtë në komunitetin tuaj zakonisht kanë marrëdhënie të shëndetshme apo jo të shëndetshme? Shpjegoni.
- › Cilat janë pengesat më të mëdha për ndërtimin e marrëdhënieve të shëndetshme? Si të silleni me to?
- › Çfarë duhet të bëni nëse mendoni se jeni në një marrëdhënie jo të shëndetshme?
- › Çfarë mund të bëni nëse shoku juaj është në një marrëdhënie jo të shëndetshme?
- › Çfarë mësuar nga ky ushtrim? Si mund ta aplikoni këtë në jetën dhe në marrëdhëniet tuaja?

Përfundimi i punëtorisë:

Një marrëdhënie e shëndetshme bazohet në respektin e ndërsjellë dhe nuk ka manipulim fizik dhe emocional, kontroll, dhunë ose abuzim. Është e rëndësishme të dini se çfarë vlerësoni në marrëdhëniet romantike dhe si të jeni këmbëngulës (kundrejt të qenit agresivë apo dominues) si dhe si të dëgjoni të tjerët. Gjithçka që ndodh në një marrëdhënie, pavarësisht nëse është një zgjedhje se çfarë të bëni në një takim apo nëse duhet të keni marrëdhënie fizike apo jo, është çështje e bisedës, respektit dhe pëlqimit të ndërsjellë.

FLETA E PUNËS: Situatat në marrëdhënie romantike

Jeni pajtuar për disa plane me partnerin/en, por ai/ajo e ka anuluar planin në minutën e fundit sepse mendon që nuk do t'ia kaloni mirë.	Ai i thotë asaj që është budallaqe – gjatë një debati.	Ju zgjidhni muzikën që doni ta dëgjoni ose shikoni atë që paraqet televizori.	Partneri juaj është kritik për miqtë tuaj.
Ju ka kapur për krahu gjatë diskutimit.	Ai vozit shpejt dhe ajo i thotë që nuk po ndihet rehat. Ai ngadalëson shpejtësinë dhe i kërkon falje asaj.	Ai i thotë miqve të tij se si “shënoi” mbrëmë, dhe në fakt ata vetëm kishin biseduar.	Ai po i bënte presion asaj për të pasur seks.
Ai e kapi për krahu gjatë diskutimit.	Edhe po të kishit besime dhe qëndrim të ndryshme, ju mund të respektoni pikëpamjet e të dyve.	Ai mendon se ajo do seks sepse është veshur me bluzë të hapur dhe fund të shkurtë.	Kur njëri prej jush ka një lajm të mirë, festojeni bashkë.
Ajo nuk dëshiron të dalë me shokët e tij. Ajo i thotë se nuk i zë besë atij që në momentin që i largohet.	Ju e paguani faturën e darkës bashkë dhe biletat e kinemasë po ashtu bashkë.	Kur dalin bashkë, ai gjithmonë i shikon femrat e tjera. Nganjëherë edhe jep komente si: “sa seksi”.	Ju zemëroheni për diçka, por gjithmonë bisedoni për atë gjë dhe e dëgjoni mendimin e të gjithëve.
Kurdo që ajo ka vështirësi ta lexojë një hartë, ai i rrotullon sytë dhe thotë “Oh, mendoj se vajzave u mungon sensi i hapësirës që në lindje”.	Ai e thërret atë të nesërmen, pas një takimi të rëndësishëm për ta falënderuar për kohën e shkëlqyer që kishte kaluar, duke shpresuar se kishte fjetur mirë.	Ajo vendos që ta tradhtojë që ta bëjë xheloz.	Ajo po e tradhton, dhe ai ia mavijos syrin asaj.
Ata shkojnë në kamp dhe para se të nisen, i shënojnë gjërat që u nevojiten, shkojnë në dyqan dhe bëhen gati bashkë.	Ajo i thotë atij se ai mund ta kërkonte ndihmë për t'i zgjedhur rrobat e tij, madje edhe se mund të puthte më mirë.	Kur e kupton se ai po e tradhtonte, ai arsyetohet se ishte i dehur dhe kësaj nuk ishte faji i tij.	Ai i bën asaj presion dhe kërkon që ta lejojë t'i bëjë asaj fotografi lakuriq. Ai planifikon që ato fotografi t'i vë në internet dhe i thotë “Oh e dashur, po dukesh shumë bukur dhe dua që e gjithë bota të të shohë”.
Një natë para esesë së rëndësishme, ai i kërkoj asaj të shkruajë një ese për të sepse nuk kishte kohë.	Ata besojnë tek njëri tjetri kur kalojnë nëpër ndonjë periudhë të vështirë në shtëpi ose në shkollë.	Ajo beson se ai duhet të jetë gjithmonë i fortë në prani të saj.	Kur është e zemëruar me të, ai dëgjon me kujdes atë që i thotë ajo.

Punëtorja nr. 8

Shtrirja e dhunës

Objektiva(t) e punëtorisë:

- › Inkurajoni të menduarit se çfarë do të thotë mbrojtje
- › Analizoni se si janë të lidhura mbrojtja dhe dhuna
- › Përcaktoni dhunën mbi bazë gjinore
- › Kuptoni se si idetë për gjininë dhe stereotipet gjinore mund të ndikojnë në mënyrën se si ne i trajtojmë njerëzit e tjerë
- › Identifikoni format e ndryshme të dhunës mbi bazë gjinore

Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:

balona (aq sa ka pjesëmarrës, flipchart me trekëndësh të vizatuar mbi të gjithë letrën e saj, letra shënuese, markera, stilolapsa.

AKTIVITETET

1. Aktiviteti fillestar: Mbrojtja e balonës

Kohëzgjatja: 15 minuta

Objektiva(t): Të inkurajohet të menduarit për atë se çfarë do të thotë mbrojtje dhe të analizohet se si është lidhja midis mbrojtjes dhe dhunës

Zhvillimi:

Shpërndani nga një balonë secilit pjesëmarrës dhe kërkojuni pjesëmarrësve t'i fryjnë ato. Udhëzoni pjesëmarrësit se si ta mbrojnë balonën e tyre për 10 minutat e ardhshme dhe sigurohuni që balona e tyre të mbetet e paprekur (të mos shpërthejë). Theksoni se ata kujdesen për veten, të tjerët dhe hapësirën përreth dhe respektojnë hapësirën e sigurt të balonës. Vëzhgoni se çfarë ndodh: a po flasin për detyrën dhe çfarë do të bëjnë si grup? Apo: a po marrin menjëherë masa dhe po përpiqen të shpërthejnë balonat e njëri-tjetrit?

Më pas bisedoni me grupin për atë që ata mendojnë se ka ndodhur.

Nëse grupi është fokusuar në shpërthimin e balonave të të tjerëve, bisedoni me ta:

- › Pse nuk e respektuan "hapësirën e sigurt" që pjesëmarrësit e krijuan për balonat e tyre?
- › Ose vendosën të përdorin dhunë?

Diskutoni keqperceptimin e shoqërisë, se të mbron atë që doni nuk do të thotë se duhet të përdorni dhunë kundër të tjerëve. Shpërthimi i balonave të njëri-tjetrit nuk ishte detyrë. Detyra ishte të ruani balonën tuaj të paprekur dhe ta mbron atë. Askush nuk tha se ata duhet të përdorin dhunë për të shpëtuar ose mbrojtur balonën e tyre.

○ 2. Aktiviteti qendror: Piramida e dhunës

Kohëzgjatja: 40 minuta

Objektiva(t): Të përcaktohet dhuna mbi bazë gjinore, të njihen idetë për gjini dhe stereotipet gjinore mund të ndikojnë në mënyrën se si i trajtojmë të tjerët, të njihen të gjitha format e dhunës mbi bazë gjinore.

Zhvillimi:

Shpërndani letrat shënuese dhe stilolapsa të mjaftueshëm për secilin pjesëmarrës. Kërkoni prej pjesëmarrësve që të mendojnë për shembuj të veçantë të veprimeve të ndryshme që mund të konsiderohen si forma të dhunës (verbale, fizike, psikologjike ose seksuale). Jepni një shembull: ofendimi në rrugë, "prekja", d.m.th., prekja e padëshiruar, goditja, etj. Jepuni pjesëmarrësve 5 minuta kohë për të menduar për shembujt e tyre dhe le t'i shkruajnë shembujt e tyre, por një shembull për çdo letër shënuese. Pasi të kenë shkruar shembujt e tyre në letër shënuese, shpjegoni se piramida përfaqëson një spektër dhune. Në krye janë format "më të këqija" të dhunës, dhe në fund format "më të buta" të dhunës. Pjesëmarrësit mund të vendosin vetë (ose të flasën me njëri-tjetrin) se ku të vendosin shembujt e tyre. Pasi të vendosen të gjithë shembujt në piramidë, diskutoni rreth spektrit të dhunës dhe mënyrës se si e krijuan atë pjesëmarrësit:

- › Çfarë vini re?
- › A ka vende dhe situata ku ka shumë dhunë?
- › A preken më shumë burra apo gra nga këto forma të dhunës?
- › Ku mund të bëjmë ndryshimin?

Në shumë raste, diskutimi mund të drejtohet drejt pyetjes nëse vrasja apo përdhunimi është më i keq për sa i përket aktit të dhunshëm. Shpjegoni se secili ka të drejtë të shprehë mendimin e tij/saj. Nëse viktimi e dhunës seksuale në këtë rast e mbijetuara e përdhunimit, përdhunimi mund të shihet si një akt më i keq dhune, sepse viktimat duhet të kalojnë traumën dhe të jetojnë me të. Sidoqoftë, përfundimi i këtij segmenti të punëtorisë nuk duhet të përfundojë në krahasimin e ndikimit të llojeve të ndryshme të dhunës – pasi ai jep një platformë për relativizimin dhe përjashtimin e mundshëm të një rasti nga një rast tjetër. Pozicioni i çdo viktime në çdo akt dhune do të mbetet i mbrojtur dhe trajtuar me dhembshuri dhe respekt maksimal për dinjitetin e tyre – dhe nëse është e mbijetuar, do të ketë të drejtën e aksesit në mekanizmat e drejtësisë dhe një dëmshpërblim të shpejtë.

Përpara se të përfundoni, shpjegoni dhe pyesni pjesëmarrësit se çfarë mendojnë ata për dhunën mbi bazë gjinore. Shpjegojuni pjesëmarrësve se dhuna mbi bazë gjinore është dhunë e bazuar në pritjet gjinore dhe/ose identitetin gjinor të një personi tjetër. Edhe pse DhBGj mund të aplikohet si te gratë edhe te burrat, vajzat dhe djemtë, fokusi i shumicës së përpjekjeve të DhBGj-së është t'i jepet fund dhunës ndaj grave dhe vajzave, pasi ato janë kategoria më e prekur nga kjo lloj dhune. Theksoni rolet dhe pritshmëritë gjinore që diskutuat në punëtorinë e kaluar.

Përfundimi i punëtorisë:

Shpjegoni se dhuna mbi bazë gjinore ndodh në një kontekst (kulturë) që banalizon, normalizon dhe provokon dhunën. Në shtresën e poshtme të piramidës është themeli. Në këtë nivel listohen format e zakonshme të dhunës mbi bazë gjinore, të cilat ndodhin çdo ditë. Shtresat e mësipërme janë më të vogla sepse janë më të rralla. Ajo që fillon si shaka mund të çojë në një sjellje më të keqe të papranueshme. Ne nuk mund të parandalojmë sulmin, abuzimin apo vrasjen, por ne mund të ndryshojmë normën dhe të bëjmë ndryshimin duke kundërshtuar trajtimin dhe fyerjet e pabarabarta.

Punëtorja nr. 9

Lufta kundër dhunës seksuale

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › Rritja e ndërgjegjësimit dhe përkrahja e formave të ndryshme të ngacmimit dhe dhunës seksuale dhe dëmet për viktimën dhe shoqërinë.
 - › Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e pëlqimit dhe nevojën për ta kërkuar para kontaktit
 - › Rritja e ndërgjegjësimit për rëndësinë e krijimit të marrëdhënieve jo të dhunshme dhe parandalimin e ngacmimeve dhe dhunës seksuale
- **Materialet e nevojshme për realizimin e punëtorisë:**
Flipchart, markerë, fletët e punës A dhe B

AKTIVITETET

○ 1. Aktiviteti fillestar: Uluni me kujdes

Kohëzgjatja: 10 minuta

Objektiva e aktivitetit fillestar: zhvillimi i kohezionit dhe besimit në grup

Zhvillimi:

Kërkoni prej pjesëmarrësve që të qëndrojnë në rreth duke prekur shpatullat e tyre. Më pas u thoni të kthehen - në mënyrë që shpatullat e tyre të djathta të jenë përballë qendrës së rrethit. Kërkoni që të gjithë të vendosin dorën mbi shpatullën e personit që kanë përpara dhe të ulen me kujdes në mënyrë që të gjithë të ulen në gjunjët e personit pas tyre. Pasi të jenë ulur me sukses, ndajeni grupin në 3 grupe.

○ 2. Aktiviteti qendror: Çfarë është dhuna seksuale?

Kohëzgjatja: 45 minuta

Objektiva(t): të njihet dhuna seksuale, të inkurajohet sjellja jo e dhunshme, të mendohet në mënyrë kritike për presionin e grupit, të njihet rëndësia e pëlqimit

Zhvillimi:

Shpjegojini pjesëmarrësve se qëllimi i këtij aktiviteti është diskutimi i dhunës seksuale. Realizoni një aktivitet të shkëmbimit të ideve për të kuptuar dhunën seksuale dhe situatat e ndryshme në të cilat mund të ndodhë ajo. Shkruani përkufizimin e dhunës seksuale nga fleta e punës A në flipchart dhe pastaj lexojeni. Jepini secilit grup një kopje të tregimit të Andrejtit. Ju mund ta lexoni po ashtu tregimin me zë të lartë për pjesëmarrësit. Pasi ta lexoni tregimin,

filloni diskutimin e hapur, inkurajoni të rinjtë të mendojnë për tregimin dhe çfarë hapash të tjerë mund të kishte ndërmarrë Andreji.

- › A është ky tregim real?
- › Si mendoni se vazhdon tregimi?
- › Çfarë mendoni për sjelljen e Andrejit?
- › Çfarë mund të konsiderohet dhunë? Pse po apo pse jo?
- › Pse mendoni se ai reagoi në këtë mënyrë?
- › Cilat mund të jenë pasojat e sjelljes së Andrejit për veten? Po për vajzën?
- › Çfarë do të kishte ndodhur nëse Andreji nuk do t'i prirëj presionit?
- › Si do ta trajtonin miqtë e tij?
- › A mund të imagjinoni një personazh tjetër në tregim? Çfarë mund të bënte ky personazh si vëzhgues?
- › Po Andreji, si mendoni se do të ndihej?

Shpjegojuni pjesëmarrësve se çfarë është pëlqimi. Pëlqimi është një marrëveshje e ndërgjegjshme dhe e gatshme e dy personave për marrëdhëniet seksuale. Ai është i nevojshëm për çdo kontakt seksual, që do të thotë se vetëm fakti që një çift ka bërë seks më parë NUK mjafton për marrëdhëniet seksuale në të ardhmen. Nëse për të bindur dikë që të kryejë marrëdhënie seksuale përdoret forca, kërcënimi me forcë ose ndonjë lloj shtrëngimi emocional - kjo NUK konsiderohet pëlqim, ashtu siç është pamundësia për të dhënë pëlqimin, për shembull nën ndikimin e alkoolit dhe drogës. Vazhdoni diskutimin me pyetjet:

- › A mund të ndodhë dhuna seksuale në marrëdhëniet ku çifti ka kryer më parë seks? Pse po ose pse jo?
- › Çfarë është pëlqimi për marrëdhënie seksuale?
- › Cila është lidhja midis pëlqimit dhe fuqisë/pushtetit në marrëdhënie?
- › A mund të ketë dhunë seksuale në marrëdhëniet martesore? Pse po ose pse jo?

Përfundojeni punëtorinë duke përdorur pyetjet e mëposhtme:

- › **Cilat janë pasojat e dhunës seksuale?**
- › **A mund të kryhet dhuna seksuale ndaj burrave? Çfarë lloji?**
- › **Si reagojnë në përgjithësi burrat?**
- › **Si mund të ndihmoni në parandalimin e situatave të dhunës seksuale në marrëdhëniet tuaja? Në komunitetin tuaj?**

FLETA E PUNËS A: Çfarë është dhuna seksuale?

Dhuna seksuale është çdo akt seksual i padëshiruar ose tentativë për t'u përfshirë në një akt seksual nëpërmjet frikësimit fizik, psikologjik ose emocional, p.sh., duke thënë "po të më doje, do të kishe marrëdhënie seksuale me mua". Presioni ose detyrimi i dikujt për të kryer akte seksuale (nga puthja deri te seksi) kundër vullnetit të tyre ose shqiptimi i komenteve seksuale, duke rezultuar në ndjenja të poshtërimit dhe paretatisë. Nuk ka rëndësi nëse kësaj i ka paraprirë ndonjë sjellje që ka lënë përshtypjen e pëlqimit për marrëdhënie seksuale. Ashtu si tek format e tjera të dhunës, elementi bazë i dhunës seksuale është shprehja e pushtetit dhe dominimit.

FLETA E PUNËS B: TREGIMI I ANDREJIT

Andreji është 18 vjeç dhe i pëlqen të shoqërohet me një grup të madh shokësh të shkollës. Ai është shumë i popullarizuar në mesin e bashkëmoshatarëve të tij dhe të gjithë duan të shoqërohen dhe të argëtohen me të. Grupi rri shpesh në shtëpinë e Josipit, me shumë muzikë dhe pije/birra. Ishte një festë. Aty kishte shumë njerëz që Andreji i njihnte. U vonua dhe sapo mbërriti, Josipi iu afrua:

Josipi: Tung shok! Më jep një pesëshe! Adriana, ajo goca e mrekullueshme, këtu është... Piu shumë. Ti je i vetmi që ende nuk e ke bërë.

Andreji: Ndal, njeri...

Josipi: Jo, dua të them... Ky është shansi yt. Mos u frikëso. Bëhu burrë! Nga ç'ka frikësohesh? Shfrytëzoje sa është ende e dehur. Vetëm vazhdo!

Andreji mund ta shihte vajzën që kishte rënë në kolltuk. Dukej që kishte pirë shumë. Mirëpo, derisa miqtë i bënë presion, Andreji iu afrua Adrianës.

Andreji: Përshëndetje, zemër... Jam unë, Andreji. Eja të shkojmë në një vend më të qetë.

Andreji e ndihmoi të ngrihej - vajza ishte aq e dehur sa ishte gjysmë e përgjumur, pothuajse u alivanos. Pavarësisht kësaj, miqtë brohorisnin teksa ai e çoi lart në dhomën e Josipit.

Punëtorja nr. 10

Të kuptuarit e homoseksualitetit

- **Objektiva(t) e punëtorisë:**
 - › Sensibilizimi ndaj pranimet të komunitetit LGBT
